



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i
vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit,
Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HISTORIKU PROCEDURAL	2
II. PARASHTRIME	5
III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	7
A. Shqyrtimi i aktakuzës.....	7
B. veprat penale dhe format e përgjegjesisë penale	8
C. ruajtja e konfidencialitetit.....	9
IV. JURIDIKSIONI.....	10
A. Juridiksioni lëndor.....	10
B. Juridiksioni kohor	13
C. Juridiksioni territorial ose individual.....	14
V. KRITERET LIGJORE	15
A. Lloji dhe fushëveprimi i shqyrtimit.....	15
1. Lloji i shqyrtimit	15
2. Fushëveprimi i shqyrtimit	17
B. Elementet e krimeve.....	18
1. Krimet kundër njerëzimit	18
2. Krimet e luftës.....	38
C. Format e përgjegjesisë penale	46
1. Ndërmarrje kriminale e përbashkët.....	46
2. Ndhurma dhe inkurajimi.....	50
3. Përgjegjësia si epror	52
VI. AKUZAT.....	55
A. Kriteret kontekstuale.....	55
1. Kriteret kontekstuale të krimeve kundër njerëzimit.....	55
2. Elementet kontekstuale të krimeve të paraqitura në Aktakuzë.....	60
B. Krimet e paraqitura në Aktakuzë	65
1. Pikat 2 dhe 3: Burgosja dhe ndalimi arbitrar	65
2. Pikat 4 dhe 5: Akte të tjera çnjerëzore dhe trajtim mizor	97
3. Pikat 6 dhe 7: Torturë	152
4. Pikat 8 dhe 9: Vrasje e paligjshme	160
5. Pika 10: Zhdukje me forcë e personave.....	184
6. Pika 2: Përndjekje	194
7. Kriteret shtesë për krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës	197
C. Format e përgjegjesisë penale në aktakuzë	201
1. Ndërmarrje kriminale e përbashkët I	201
2. Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët III.....	214
3. Ndhurma dhe inkurajimi.....	216
4. Përgjegjësia eprore	218
VII. KËRKESA SHOQËRUESE PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT	233
VIII. VENDIM.....	236

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenin 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr vendimin në vijim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

2. Më 28 maj 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi një kërkesë për: (i) lëshimin e fletarrestimeve për Hashim Thaçin (“z. Thaçi”), Kadri Veselin (“z. Veseli”), Rexhep Selimin (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqin (“z. Krasniqi”) (bashkërisht, “të dyshuarit”) dhe urdhrave përkatës të transferimit; (ii) autorizim për kontrollim dhe sekuestrim, [REDAKTUAR]; dhe (iii) mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës, dokumenteve shoqëruese dhe identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave.³

3. Më 2 qershor 2020, Prokurori i Specializuar kërkoi të shtonte material mbështetës tjetër dhe dorëzoi një përmbledhje të detajuar të përditësuar.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, konfidencial.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim* (“Parashtrimi fillestar”), 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave në lidhje me to* (“Parashtrim për urdhra të ndërlydhur”), 28 maj 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00006, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për paraqitjen e materialeve mbështetëse shtesë*, 2 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën 1 dhe shtojcën 2 (“Përmbledhja e përditësuar e ZPS-së”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 17 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi dorëzimin e materialit mbështetës shtesë dhe të përmbledhjes së detajuar të përditësuar.⁵

5. Më 23 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me kërkesë të Prokurorit të Specializuar,⁶ autorizoi nxjerrjen publike të informacionit në vijim nga Aktakuza, konkretisht të informacionit lidhur me: (i) identitetet e z. Thaçi dhe të z. Veseli si të dyshuar për të cilët ishte ngritur aktakuzë; dhe (ii) numrin e akuzave, cilësimin ligjor dhe llojin e krimeve të pretenduara, numrin e përafërt të viktimave të identifikuar, dhe përkatësinë ose kombësinë e tyre.⁷

6. Më 2 korrik 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një urdhër në të cilin i kërkonte Prokurorit të Specializuar që të përgatiste një aktakuzë të rishikuar dhe të përfshinte një paraqitje të detajuar të fakteve, ku të bënte një përshkrim më konkret të pretendimeve faktike për secilën vepër penale.⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu kërkoi që Prokurori i Specializuar të ngrinte akuza kundër katër të dyshuarve vetëm në bazë të neneve 13, 14, dhe 16 të Ligjit.⁹

7. Më 24 korrik 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi një aktakuzë të rishikuar për konfirmim (“Aktakuza e Rishikuar”), sikurse i ishte kërkuar.¹⁰

⁵ KSC-BC-2020-06, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për paraqitjen e materialeve mbështetëse shtesë*, 17 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00008, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për autorizim për nxjerrje informacioni në lidhje me Aktakuzën*, 23 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00009, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën urgjente të Prokurorit të Specializuar*, 23 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores (“Urdhër në pajtim me rregullën 86(4)”),* 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 22 dhe 27(a).

⁹ Urdhër në pajtim me rregullën 86(4), para. 23, 26, 27(b).

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim (“Parashtrimi i Dytë”),* 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcën 1 (“Aktakuza e Rishikuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

8. Më 29 korrik 2020, Prokurori i Specializuar kërkoi autorizim për herë të dytë për dorëzimin e materialit mbështetës shtesë.¹¹
9. Më 30 korrik 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi dorëzimin e materialit mbështetës shtesë dhe urdhëroi dorëzimin e një përmbledhjeje të detajuar plotësuese.¹²
10. Më 12 gusht 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi përmbledhjen e detajuar plotësuese, sipas urdhrit.¹³
11. Më 18 shtator 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një urdhër në të cilin i kërkoi Prokurorit të Specializuar të sqaronte mospërputhjet ndërmjet Aktakuzës së Rishikuar dhe përmbledhjes së detajuar në lidhje me disa vendndodhje dhe persona dhe, nëse do të ishte e nevojshme, të dorëzonte një aktakuzë të rishikuar për herë të dytë.¹⁴
12. Më 21 shtator 2020, Kryetarja caktoi shtetin pritës, Holandën, si vendin e procedimit të kësaj çështjeje dhe të aspekteve lidhur me të.¹⁵
13. Më 24 shtator 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi sqarime lidhur me akuzat, në pajtim me urdhrin, dhe e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se nuk synon të dorëzojë një aktakuzë të rishikuar për herë të dytë.¹⁶

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00012, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e dytë për paraqitjen e materialit mbështetës shtesë*, 29 korrik 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹² KSC-BC-2020-06, F00013, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i dytë mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për paraqitjen e materialit mbështetës shtesë*, 30 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00014, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i përmbledhjes së detajuar plotësuese sipas rregullës 86(3)(b)*, 12 gusht 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00016, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër i dytë drejtuar Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores*, 18 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00017, President, *Vendim mbi kërkesën për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës*, 21 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00018, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim në bazë të urdhrit KSC-BC-2020-06/F00016*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

14. Më 19 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një urdhër për caktimin e një date të synuar për nxjerrjen e këtij vendimi.¹⁷

II. PARASHTRIME

15. Në Aktakuzën e Rishikuar, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) akuzon të dyshuarit për krime kundër njerëzimit të kryera në kontekstin e një sulmi të përhapur gjerësisht ose sistematik kundër popullatës civile (neni 13 i Ligjit) dhe krime lufte të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar (neni 14(1)(c) i Ligjit).¹⁸ Më konkretisht, ZPS-ja pretendon kryerjen e krimeve të përndjekjes (Pika 1),¹⁹ burgosjes/ndalimit arbitrar (Pikat 2 dhe 3),²⁰ akteve të tjera çnjerëzore/trajtimin mizor (Pikat 4 dhe 5),²¹ torturës (Pikat 6 dhe 7),²² vrasjes së paligjshme (Pikat 8 dhe 9)²³ dhe zhdukjes me forcë të personave (Pika 10)²⁴ në periudhën midis së paku marsit 1998 deri në shtator 1999 (“periudha e Aktakuzës”),²⁵ në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë Veriore.²⁶ Sipas ZPS-së, të dyshuarit kanë personalisht përgjegjësi penale, sepse midis së paku marsit 1998 dhe shtatorit 1999, përmes pjesëmarrjes së tyre në një ndërmarrje kriminale të përbashkët (në formën bazë dhe të zgjeruar)²⁷ kanë kryer dhe/ose kanë ndihmuar ose inkurajuar²⁸ krimet në Pikat 1-10. Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se, si

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e një date të synuar për vendim në bazë të nenit 39(2)*, 19 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁸ Aktakuza e Rishikuar, para. 16-31, 173-174 [68].

¹⁹ Aktakuza e Rishikuar, para. 57-58, 174 [68].

²⁰ Aktakuza e Rishikuar, para. 59-94, 174 [68].

²¹ Aktakuza e Rishikuar, para. 95-134, 174 [68].

²² Aktakuza e Rishikuar, para. 136, 174 [68].

²³ Aktakuza e Rishikuar, para. 137-171, 174 [68].

²⁴ Aktakuza e Rishikuar, para. 172, 174 [68].

²⁵ Aktakuza e Rishikuar, para. 16, 18, 57, 59, 95-96, 136-137, 172.

²⁶ Aktakuza e Rishikuar, para. 57, 59, 95-96, 136-137, 172, Listat A-C.

²⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 32-51, 173, 174 [68]. ZPS-ja pretendon si alternativë se të dyshuarit kryen, tërësisht ose pjesërisht, krimet e paraqitura në Pikat 1-10 përmes formës së zgjeruar të ndërmarrjes kriminale të përbashkët. *Shih* Aktakuza e Rishikuar, para. 34.

²⁸ Aktakuza e Rishikuar, para. 52, 173, 174 [68].

alternativë, të dyshuarit kanë personalisht përgjegjësi penale si eprorë për krimet në Pikat 1-10 sipas nenit 16(1)(c) të Ligjit.²⁹

16. Krahas kërkesës për konfirmimin e Aktakuzës së Rishikuar,³⁰ ZPS-ja kërkon mosnxjerrjen e përkohshme për publikun dhe të akuzuarit të Aktakuzës së Rishikuar, dokumenteve dhe informacionit shoqërues deri në një urdhër të mëtejshëm³¹ si dhe mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave deri në urdhërimin e masave të duhura mbrojtëse.³² ZPS-ja argumenton se ekzistojnë rreziqe reale që të dyshuarit të arratisen,³³ të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave³⁴ dhe të kryejnë krime të mëtejshme³⁵, që dëshmojnë për arsye të vlefshme që i përlligjin këto kërkesa.

17. Për të zbatuar mosnxjerrjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave, ZPS-ja kërkon: (i) mosnxjerrjen e emrit dhe informacionit identifikues të dëshmitarëve dhe viktimave për publikun; (ii) redaktime të identitetit dhe informacionit identifikues, si dhe caktimin e pseudonimeve të përkohshme për dëshmitarët dhe viktimat e përmendur me emër përpara se këto t'i bëhen të ditura të dyshuarve ose publikut (iii) vazhdimin e mosnxjerrjes deri në një vendim të mëtejshëm pas një kërkesë të ZPS-së ose pas dëgjimit të argumenteve të ZPS-së.³⁶

²⁹ Aktakuza e Rishikuar, para. 53-55, 173, 174 [68].

³⁰ Parashtrimi Fillestar, para. 7(i).

³¹ Parashtrimi Fillestar, para. 5, 7(ii); Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 2, 55, 60(e); Parashtrimi i Dytë, para. 7.

³² Parashtrimi Fillestar, para. 5, 7(ii); Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 2, 54, 60(d); Parashtrimi i Dytë, para. 7.

³³ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 31-33.

³⁴ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 34-38.

³⁵ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 39-40.

³⁶ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 54(a)-(c).

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. SHQYRTIMI I AKTAKUZËS

18. Neni 39(1) dhe (2) i Ligjit dhe rregulla 86(4) e Rregullores përcaktojnë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën. Në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe rregullës 86(4) dhe (5) të Rregullores, në qoftë se bindet se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmon aktakuzën. Në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bindet për sa më lart, aktakuza ose akuzat e paraqitura në aktakuzë hidhen poshtë. Rregulla 86(5) e Rregullores përcakton që Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të nxjerrë një vendim të arsyetuar.

19. Në bazë të rregullës 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një paraqitje të shkurtër të fakteve të çështjes gjyqësore dhe të veprës apo veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari, veçanërisht formën e përgjegjësisë penale që pretendohet lidhur me veprat penale në aktakuzë. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, përkatësisht me materialin provues që mbështet faktet mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

20. Pas konfirmimit të akuzës ose akuzave të paraqitura në aktakuzë, rregulla 86(6) e Rregullores përcakton që i dyshuari bëhet i akuzuar dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë vendime ose urdhra të tjerë të paraparë në nenin 39(3) të Ligjit.

21. Sipas rregullës 86(8) dhe (10) të Rregullores, Administratori ruan aktakuzën e konfirmuar, përgatit kopje të legalizuara të aktakuzës së konfirmuar me vulën e Dhomave të Specializuara dhe njofton Kryetarin për aktakuzën e konfirmuar.

B. VEPRAT PENALE DHE FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

22. Krahas kryerjes së gjyqimit në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin, dispozitat e legjislacionit të Kosovës të përfshira shprehimisht në Ligj, dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Dhomat e Specializuara, në pajtim me nenet 3(2)(d), (3), dhe 12 të Ligjit, zbatojnë edhe të drejtën zakonore ndërkombëtare të zbatueshme në kohën e kryerjes së krimeve përkatëse. Në përcaktimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme në kohën e kryerjes së veprave penale, gjykatësi mund të mbështetet në burime të së drejtës ndërkombëtare, ndër të cilat edhe burime dytësore, si për shembull jurisprudenca e tribunalëve ndërkombëtarë të përkohshëm, e Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe e gjykatave të tjera penale.

23. Neni 13 i Ligjit përcakton se në kuadër të këtij Ligji, sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, krim kundër njerëzimit cilësohet cildo prej akteve në vijim në qoftë se kryhet si pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër çfarëdo popullate civile: (i) vrasje e paligjshme; (ii) shfarosje; (iii) skllavërim; (iv) dëbim; (v) burgosje (vi) torturë, (vii) përdhunim, skllavërim seksual, prostituim me detyrim, shtatzani me detyrim dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale; (viii) përndjekja për arsye politike, racore, etnike ose fetare, (ix) zhdukje me forcë e personave; dhe (x) akte të tjera çnjerëzore.

24. Neni 14(1)(c) i Ligjit përcakton se në kuadër të këtij Ligji, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, me krime lufte në rastin e një konflikti të armatosur me karakter jondërkombëtar kuptohen shkelje të rënda të nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 (“neni i përbashkët 3”), përfshirë edhe cildo prej akteve në vijim të kryer kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që i kanë dorëzuar

armët dhe ata që janë jashtë luftimit për arsye të sëmundjes, plagëve, ndalimit, ose çfarëdo shkakut tjetër: (i) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e paligjshme të të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura; (ii) cenimi i dinjitetit personal, në veçanti trajtimet poshtëruese dhe degraduese; (iii) marrja e pengjeve, dhe (iv) shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa vendim paraprak nga një gjykatë e themeluar në mënyrë të rregullt që siguron të gjitha garancitë gjyqësore të pranuar përgjithësisht si të domosdoshme.

25. Për krimet në nenet 13 dhe 14 të Ligjit, neni 16(1)(a) i Ligjit përcakton, ndër të tjera, se personi i cili ka nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe ka ndihmuar dhe inkurajuar planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtij krimi, mban përgjegjësi individuale për krimin. Neni 16(1)(c) i Ligjit më tej përcakton se fakti që një veprim ose mosveprim është kryer nga një vartës nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi ishte në prag të kryerjes së akteve të tilla ose i kishte kryer ato dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e këtyre akteve ose për ndëshkimin e kryesve.

C. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

26. Neni 39(11) i Ligjit përcakton se, kur është e nevojshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë masa për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

27. Rregulla 85(4) e Rregullores përcakton se, varësisht prej rregullës 102 të Rregullores, të gjitha dokumentet dhe informacioni që Zyra e Prokurorit të Specializuar i paraqet Gjykatësit të Procedurës Paraprake gjatë hetimeve mbeten më së paku konfidenciale dhe *ex parte*.

28. Sipas rregullës 88 të Rregullores, aktakuza bëhet publike pas konfirmimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Megjithatë, në rrethana të veçanta dhe

pasi të jenë paraqitur arsye të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë përkohësisht mosnxjerrjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose informacionit që kanë lidhje me aktakuzën, deri në një urdhër të mëtejshëm. Sidoqoftë, aktakuza bëhet publike, me redaktimet e nevojshme, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit. ZPS-ja mund t'ua bëjë të njohur aktakuzën ose pjesë të saj autoriteteve të një shteti të tretë ose një subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për nevojat e hetimit ose ndjekjes penale.

29. Rregulla 102(1)(a) Rregullores përcakton që ZPS-ja i vë në dispozicion të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por së paku brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialin mbështetës të aktakuzës së dorëzuar për konfirmim si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit.

30. Rregulla 105(1) e Rregullores përcakton që ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë panelit për mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të një dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, deri sa të jenë urdhëruar masat e duhura mbrojtëse.

IV. JURIDIKSIONI

31. Që të konfirmohet, aktakuza duhet të plotësojë kriterin e juridiksionit lëndor dhe kohor dhe juridiksioni duhet të bazohet ose në elementin territorial, ose në atë individual.

A. JURIDIKSIONI LËNDOR

32. Në bazë të nenit 6 të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krimet e përmendura në nenet 12-15 të Ligjit. Përndjekja, burgosja, aktet e tjera çnjerëzore, tortura, vrasja e paligjshme dhe zhdukja me forcë e personave si krime kundër njerëzimit, sikurse parashtrohen nga Prokurori i Specializuar (Pikat 1, 2,

4, 6, 8 dhe 10), përmenden në nenin 13 të Ligjit dhe rrjedhimisht janë brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara. Po kështu, trajtimi mizor, tortura dhe vrasja e paligjshme si krime lufte, sikurse parashtrihen nga Prokurori i Specializuar (Pikat 5, 7 dhe 9), përmenden në nenin 14(1)(c)(i) të Ligjit dhe rrjedhimisht janë brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara.

33. Në Aktakuzën e Rishikuar, ZPS-ja parashtron se të dyshuarit mbajnë gjithashtu përgjegjësi penale për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 3), që përbën shkelje të nenit 14(1)(c) të Ligjit.³⁷ Ndonëse kjo dispozitë nuk e përmend shprehimisht ndalimin arbitrar si krim lufte në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, krimet brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara nuk kufizohen vetëm në ato që renditen shprehimisht në këtë dispozitë. Gjithsesi, që Dhomat e Specializuara të kenë juridiksion mbi një krim që nuk përmendet në nenin 14(1)(c)(i)-(iv) të Ligjit, një krim i tillë: (i) duhet të përbëjë shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 dhe (ii) të ketë qenë i ndaluar prej së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur është kryer, në përputhje me nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit.

34. Neni i përbashkët 3 përcakton se “personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime ndër të cilët [...] ata të dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose çfarëdo shkakut tjetër, trajtohen njerëzisht në çfarëdo rrethane [...]”. Kjo mbrojtje e përcaktuar gjithashtu në nenin 4(1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II) i 8 qershorit 1977, duhet të zbatohet nga të gjitha palët në konfliktin e armatosur dhe duhet t’u akordohet të gjithë personave të ndaluar, pavarësisht nga arsyeja për heqjen e lirisë.³⁸ Kushti i trajtimit njerëzor përbën një detyrim themelor në të drejtën

³⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 59-94, 174 [68].

³⁸ ICRC, *Commentary on the First Geneva Convention: Convention (I) for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field*, Botim i dytë, 2016 (“Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 2016”)

humanitare ndërkombëtare dhe pasqyron të drejtën zakonore ndërkombëtare.³⁹

Ky kusht përfshin më tepër se aktet e ndaluara të përmendura shprehimisht në nenin e përbashkët 3, të cilët janë shembuj të veprimeve që janë pakundërshtueshmërisht në shkelje të dispozitës.⁴⁰

35. Heqja e lirisë pa bazë ligjore ose në shkelje të garancive bazë nuk është e pajtueshme me standardin e trajtimit njerëzor të të gjithë personave jashtë luftimit, ndër të cilët edhe personat mbajtur në ndalim, dhe është shkelje e këtij standardi të mishëruar në nenin e përbashkët 3.⁴¹

36. E drejta zakonore ndërkombëtare ndalon heqjen arbitrare të lirisë. Praktikrat e shumta shtetërore, ndër të tjera në formën e udhëzuesve ushtarakë, legjislacionit penal, dokumenteve të organizatave dhe konferencave ndërkombëtare, si dhe të organeve ndërkombëtare gjyqësore ose thuajse gjyqësore, vërtetojnë zbatueshmërinë e kësaj mbrojtjeje në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare.⁴² Këtë ka konfirmuar edhe KNKK-ja në rregullën 99 të Studimit

përcakton në lidhje me nenin e përbashkët 3: “është e pakontestueshme se dispozitat materiale të nenit të përbashkët 3 janë detyruese për çdo grup të tillë të armatosur që është palë në një konflikt të armatosur” (para. 508). *Shih gjithashtu ICRC, Commentary on the Additional Protocols to the Geneva Conventions, 1987* (“Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 1987 për Protokollin Shtesë II”) lidhur me nenin 1 (para. 4460, 4470). Lidhur me nenin 5, Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 1987 për Protokollin Shtesë II sqaron se shprehja “ata të cilët janë përgjegjës për internim dhe ndalim” u referohet “personave të cilët janë përgjegjës *de facto* për kampe, burgje ose vende të tjera ndalimi, të pavarura nga cilido autoritet i njohur ligjor” (para. 4582).

³⁹ *Shih rregulla 87, në Henckaerts J.-M., Doswald-Beck L., Customary International Humanitarian Law* (“CIHL Study”), Vol. I (Rregullat), Cambridge University Press 2005, f. 306. *Shih gjithashtu ICJ/GJND, Case Concerning the Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua (Nicaragua v. United States of America), Merits, Judgment of 27 June 1986, para. 218; ICTY/TPNJ, Prosecutor v. Tadić, IT-94-1-AR72, Appeals Chamber, Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction* (“Vendimi Tadiq mbi juridiksionin”), 2 tetor 1995, para. 98.

⁴⁰ 2016 *ICRC Commentary regarding Common Article 3, para. 555; ICTY/TPNJ, Prosecutor v. Aleksovski, I-95-14/1, Trial Chamber, Judgment, 25 qershor 1999, para. 49.*

⁴¹ *Rule 99, CIHL Study, Vol. I (Rregullat), f. 344.*

⁴² *Shih praktikën e përmendur në Rule 99, CIHL Study Vëll. I (Rregullat), f. 347; Vëll. II (Praktikat), f. 2331-2344, në veçanti f. 2331 (para. 2555), 2332 (para. 2563), 2333 (para. 2576, 2579, 2580), 2334 (para. 2593), 2335 (para. 2599, 2600, 2605), 2336 (para. 2606, 2607, 2608, 2611); UN Security Council Resolutions: 1019 (1995), U.N. Doc. S/RES/1019, 9 nëntor 1995; 1034 (1995), U.N. Doc. S/RES/1034, 21 dhjetor 1995; UN General Assembly Resolution 50/193 (1996), 11 mars 1996; UN Commission on Human Rights, Situation of human rights in the Republic of Bosnia and Herzegovina, the State of Bosnia and Herzegovina, the Republic of*

të së Drejtës Zakonore Humanitare Ndërkombëtare të vitit 2005.⁴³

37. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 dhe, në kohën e kryerjes së krimeve të paraqitura në Aktakuzën e Rishikuar, ndalohej prej të drejtës zakonore ndërkombëtare. Si në kontekstin shtetëror, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, ligji ishte i qartë dhe i parashikueshëm në masë të mjaftueshme sa të mundësonte pritshmërinë e gjasës së përgjegjësisë penale individuale për heqjen arbitrare të lirisë së një personi.⁴⁴

38. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi këtë krim lufte sipas nenit 14(1)(c) në kombinim me nenin 12 të Ligjit.

B. JURIDIKSIONI KOHOR

39. Neni 7 i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krimet brenda juridiksionit të tyre lëndor të kryera midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000. Duke marrë parasysh pretendimin e Prokurorit të Specializuar se krimet në Pikat 1-10 u kryen së paku midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999,⁴⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se krimet janë brenda juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara.

Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia (Serbia and Montenegro), U.N. Doc. E/CN.4/RES/1996/71, 23 prill 1996; *UN Commission on Human Rights, Situation of human rights in the Sudan*, U.N. Doc. E/CN.4/RES/1996/73, 23 prill 1996, para. 15. *Shih gjithashtu* nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ((1976) ("Kodi Penal i RSFJ-së").

⁴³ *Rule 99, CIHL Study*, Vëll. I (Rregullat), f. 344.

⁴⁴ *Shih gjithashtu* nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së.

⁴⁵ Aktakuza e Rishikuar, para. 16, 57, 59, 95, 136, 137, 172.

C. JURIDIKSIONI TERRITORIAL OSE INDIVIDUAL

40. Në bazë të nenit 8 të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krime brenda juridiksionit të tyre lëndor të cilat kanë filluar të kryhen ose janë kryer në Kosovë. Në bazë të nenit 9(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion individual kur i dyshuari është person me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) (parimi i personalitetit aktiv), ose krimet janë kryer kundër personave me shtetësi të Kosovës/RFJ-së (parimi i personalitetit pasiv), kudo që të jenë kryer. Rrjedhimisht, elementi territorial dhe individual janë alternativa të njëri-tjetrit. Përmbushja e njërit prej këtyre kriterëve është e mjaftueshme për të bërë konstatim konfirmues në lidhje me juridiksionin.

41. Në rastin në fjalë, pretendohet se pjesa më e madhe e krimeve u kryen në vende brenda territorit të Kosovës, si në: Likoc dhe [REDAKTUAR]; Jabllanicë; Llapushnik dhe malet e Berishës; Drenoc; Malishevë dhe shpellën e Volljakës; [REDAKTUAR]; Bare dhe Bajgorë; Llapashticë, [REDAKTUAR], Majac, Potok dhe [REDAKTUAR]; Zllash; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; Kleçkë dhe [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; Prizren; Ferizaj; [REDAKTUAR]; Gjilan; Suharekë; Rahovec; Novobërdë; [REDAKTUAR]; dhe [REDAKTUAR] ⁴⁶ . Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është përmbushur kushti i juridiksionit territorial i përcaktuar në nenin 8 të Ligjit.

42. Sa u përket krimeve që pretendohet se janë kryer në territorin e Shqipërisë, si për shembull në rrethet e Kukësit dhe Hasit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se të dyshuarit, të lindur në Kosovë,⁴⁷ pretendohet se ishin shtetas të RFJ-së gjatë të gjitha periudhave që kanë lidhje me Aktakuzën e Rishikuar.⁴⁸ Për këtë

⁴⁶ Aktakuza e Rishikuar, para. 60-77, 80-94, 98-115, 119-134, 138-164, 166-171.

⁴⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 1, 4, 7, 10.

⁴⁸ Aktakuza e Rishikuar, para. 1, 4, 7, 10; *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; IT-04-84 P00340, f. 4, 6, 173 (3288, 3290, 3457).

arsye Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është përmbushur kriteri i juridiksionit individual aktiv i nenit 9(2) të Ligjit.

43. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se çështja është brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

V. KRITERET LIGJORE

A. LLOJI DHE FUSHËVEPRIMI I SHQYRTIMIT

1. Lloji i shqyrtimit

44. Konfirmimi i aktakuzës është një proces *ex parte* pa përfshirjen e Mbrojtjes. Shqyrtimi në procedurë paraprake siguron që në gjykim të shqyrtohen vetëm ato akuza për të cilat janë paraqitur prova të mjaftueshme. Gjithashtu ai siguron që aktakuza t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij ose saj, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.⁴⁹

45. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(1) të Rregullores, Prokurori i Specializuar dorëzon aktakuzën së bashku me materialin mbështetës për t'u shqyrtuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Gjatë procesit të shqyrtimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton nëse aktakuza i plotëson kriteret e rregullës 86(3) të Rregullores, në veçanti të ekzistencës së informacionit të mjaftueshëm për sa i përket emrit dhe të dhënave personale të të akuzuarit, paraqitjes së fakteve dhe paraqitjes së krimeve,⁵⁰ si dhe nëse është e nevojshme që t'i kthehet Prokurorit të Specializuar, në bazë të rregullës 86(4)(a)-(c) të

⁴⁹ Urdhër në pajtim me rregullën 86(4), para. 9.

⁵⁰ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet t'u kushtojë vëmendjen e duhur të drejtave të të akuzuarit të parapara në nenin 21(4)(a), (c) dhe (d) të Ligjit, i cili është pasqyrim i nenit 6(1), (3)(a) dhe (b) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ") dhe i nenit 14(3)(a), (b) dhe (c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP").

Rregullores. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund t'i kërkojë ose lejojë Prokurorit të Specializuar të paraqesë material shtesë në mbështetje të cilësdo prej akuzave ose të gjitha akuzave. Në vijim, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe përcaktimeve të përgjithshme të rregullës 86(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton materialin mbështetës në lidhje me secilën prej akuzave në aktakuzë, për të përcaktuar nëse ZPS-ja ka vërtetuar një dyshim të bazuar mirë se i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

46. Ndonëse as Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë dyshimin e bazuar mirë, bëhet diferencim i qartë i këtij standardi prej standardeve të tjera të provave që parashihen në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Ligji parasheh katër standarde provash me përshkallëzim progresiv: (i) arsye për të besuar (në nenin 38(3)(a) të Ligjit dhe rregullën 43(1) të Rregullores, lidhur me statusin e të dyshuarve); (ii) dyshim i bazuar (në nenin 41(6) të Ligjit, lidhur me fletarrestimet e Dhomave të Specializuara ose urdhërarrestimet e ZPS-së); (iii) dyshim i bazuar mirë (në nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 86(4) të Rregullores, lidhur me konfirmimin e një aktakuze); dhe (iv) jashtë dyshimit të arsyeshëm (në nenin 21(3) të Ligjit dhe rregullën 158(3) të Rregullores, lidhur me vendimet e fajësisë). Si standardi që përdoret për fillimin e procedimit kundër një të akuzuari, standardi i dyshimit të bazuar mirë është domosdoshmërisht më i lartë sesa standardet e kërkuara për përcaktimin se cilët janë të dyshuarit dhe për urdhërimin e arrestimeve, si dhe është qartësisht më i ulët sesa standardi për vendimin e fajësisë pas përfundimit të gjykimit.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në bazë të nenit 19.1.12 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës 2012, ("KPP"), dyshimi i bazuar mirë arrihet kur provat "do të bindnin një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka

ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”.⁵¹ Në veçanti, nuk është e mjaftueshme që vëzhguesi objektiv të bindet se “ka më shumë gjasa që personi në fjalë të ketë kryer veprën penale sesa të mos e ketë kryer”, sikurse kërkohet në lidhje me dyshimin e bazuar sipas nenit 19.1.9 të KPP-së.

48. Rrjedhimisht, ndonëse më i ulët se standardi i qartësisë së një fakti të vërtetuar, përcaktimi i ekzistencës së dyshimit të bazuar mirë gjithsesi kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet, përtej teorisë apo dyshimit të thjeshtë se: (i) elementët kontekstualë të krimit (nëse është kryer krim) janë të pranishëm; (ii) aktet ose krimet bazë kanë ndodhur me të vërtetë; dhe (iii) i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimit përmes formës ose formave të pretenduara të përgjegjësisë penale. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bazon këto konstatime në material mbështetës konkret dhe të qartë, i cili demonstroi një linjë të qartë arsyetimi mbi të cilën bazohen akuzat në aktakuzë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vlerëson materialin mbështetës në tërësinë e tij, pa bërë shqyrtim të imtë të secilës prej provave.⁵²

2. Fushëveprimi i shqyrtimit

49. Në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores, për të përcaktuar nëse ekziston dyshimi i bazuar mirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton vetëm aktakuzën, përmbledhjen e detajuar dhe materialin mbështetës, pa marrë parasysh informacione apo materiale të tjera jothelbësore, edhe nëse këto janë të

⁵¹ Termi “objektiv” përkufizohet (në anglishte) si “që nuk ndikohet nga ndjenjat dhe mendimet vetjake në shqyrtimin dhe përshkrimin e fakteve; i paanshëm, i distancuar”, *shih OED Online* (Oxford University Press, dhjetor 2019), gjendet në <https://www.oed.com/view/Entry/129634?redirectedFrom=objective#eid> (parë për herë të fundit më 20 tetor 2020).

⁵² Në mënyrë të ngjashme, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-803-tEN, Pre-Trial Chamber I, *Decision on the Confirmation of Charges*, 29 janar 2007, para. 39; *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-656-Red, Pre-Trial Chamber I, *Decision on the Confirmation of Charges Against Laurent Gbagbo* (“Gbagbo Decision on Confirmation of Charges”), 12 qershor 2014, para. 22.

disponueshme publikisht. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund ta konfirmojë ose hedhë poshtë aktakuzën vetëm mbi bazën e informacionit dhe materialit provues të dorëzuar nga ZPS-ja.⁵³

50. Si pjesë e procesit të shqyrtimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kryen një vlerësim paraprak të materialit mbështetës, pa ndërhyrë në kompetencat e trupit gjykues, për të përcaktuar pranueshmërinë dhe rëndësinë e provave sikurse parashihet në rregullat 137-139 të Rregullores.⁵⁴ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të mbështetet në material që është qartësisht (i) joautentik ose (ii) është siguruar nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit, Rregullores, ose standardeve të së drejtës së të drejtave të njeriut, ose me anë të torturës apo çfarëdo forme të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues, sikurse parashihet në rregullën 138(2)-(3) të Rregullores.

B. ELEMENTET E KRIMEVE

1. Krimet kundër njerëzimit

(a) Kriteret kontekstuale të krimeve kundër njerëzimit

51. Kriteret kontekstuale të krimeve kundër njerëzimit përbëhen nga: (i) sulmi i përhapur gjerësisht ose sistematik kundër çfarëdo popullate civile; (ii) lidhja ndërmjet krimit bazë dhe sulmit; dhe (iii) dijenia për sulmin.⁵⁵

⁵³ Në mënyrë të ngjashme, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-17-07/I/AC/R176bis, Appeals Chamber, *Interlocutory Decision on the Applicable Law: Criminal Association and Review of the Indictment*, 18 tetor 2017, para. 111.

⁵⁴ Në mënyrë të ngjashme, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I, Pre-Trial Judge, *Decision Relating to the Examination of the Indictment of 10 June 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra*, 28 qershor 2011, para. 26.

⁵⁵ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kunarac et al.* IT-96-23-T & IT-96-23/1-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“Kunarac et al Trial Judgment”), 22 shkurt 2001, para. 410; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Public Redacted Version of Judgment Issued on 24 March 2016](#) (“Karadžić Trial Judgment”), 24 mars 2016, para. 472; *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“Mladić Trial Judgment”), 22 nëntor 2017, para. 3023.

(i) *Sulm i përhapur gjerësisht ose sistematik kundër çfarëdo popullate civile*

52. *Sulm*. Termi “sulm” i referohet një fushate, operacioni ose praktike veprimi që përfshin kryerjen e më shumë veprimeve të dhunës dhe keqtrajtimit kundër çfarëdo popullate civile, duke përfshirë edhe veprimet e përmendura në nenin 13 të Ligjit.⁵⁶ Nuk është e nevojshme që veprimet të cilat përbëjnë një “sulm” të jenë të ndëshkueshme si krime kundër njerëzimit,⁵⁷ e as që “sulmi” të përbëjë sulm ushtarak.⁵⁸ Koncepti i “sulmit” brenda kuptimit të nenit 13 të Ligjit dhe ai i “konfliktit të armatosur” brenda kuptimit të nenit 14 të Ligjit, nuk janë të njëjtë.⁵⁹ Rrjedhimisht, sulmi mund t’i paraprijë, të shkojë përtej, ose të vazhdojë gjatë konfliktit të armatosur, por jo domosdoshmërisht si pjesë e konfliktit.⁶⁰ Në përcaktimin nëse ka pasur “sulm” kundër një popullate të caktuar civile, nuk ka rëndësi që edhe pala tjetër të ketë kryer krime mizore.⁶¹

53. *Drejtuar kundër çfarëdo popullate civile*. Sikurse saktësohet në vetë shprehjen “drejtuar kundër”, sulmi duhet të synojë një popullatë civile, një kolektiv që është objektivi parësor i sulmit, dhe jo viktimë e rastësishme të tij.⁶² Nuk është e

⁵⁶ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 417; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Kunarac et al. Appeal Judgment”), 12 qershor 2002, para. 86; *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Blagojević and Jokić Trial Judgment”), 17 janar 2005, para. 543; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Akayesu*, ICTR-96-4-T, Trial Chamber, [Judgement](#), (“Akayesu Trial Judgment”), 2 shtator 1998, para. 581; *Prosecutor v. Rutaganda*, ICTR-96-3-T, Trial Chamber, [Judgement and Sentence](#), 6 dhjetor 1999, para. 70.

⁵⁷ ECCC/DHJGJK, *Co-Prosecutors v. Kaing Guek Eav*, 001/18-07-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Duch Trial Judgment”), 26 korrik 2010, para. 298; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Nahimana et al. Appeal Judgment”), 28 nëntor 2007, para. 915-918.

⁵⁸ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 416; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-424, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Bemba Gombo](#) (“Bemba Decision on Confirmation of Charges”), 15 qershor 2009, para. 75.

⁵⁹ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3024; [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 416.

⁶⁰ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 86; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 473.

⁶¹ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 87.

⁶² ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3026; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 92; ICC/GJPN, *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 76; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3436-tENG, Trial Chamber II, [Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute](#), (“Katanga Trial Judgment”), 7 mars 2014, para. 1104.

domosdoshme që Prokurori i Specializuar të provojë se e gjithë popullsia e zonës gjeografike ku ka ndodhur sulmi duhet të ketë qenë objekt i sulmit.⁶³ Përkundrazi, mjafton të provohet se gjatë sulmit u sulmuan një numër i mjaftueshëm personash, ose se ata u sulmuan në një mënyrë që e bën të qartë se sulmi faktikisht ishte i drejtuar kundër një popullate civile dhe jo kundër një numri të kufizuar personash të përzgjedhur në mënyrë rastësore.⁶⁴ Shprehja “popullatë civile” interpretohet në kuptimin e gjerë dhe u referohet personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, në dallim nga anëtarët e forcave të armatosura dhe luftëtarët e tjerë të ligjshëm.⁶⁵ Prania e personave jocivilë brenda një popullate nuk e ndryshon karakterin civil të popullatës.⁶⁶ Qëllimi i sulmit nuk është i rëndësishëm në përcaktimin nëse sulmi është i drejtuar kundër çfarëdo popullate civile.⁶⁷ Për më tepër, formulimi “çfarëdo” popullate civile nënkupton që neni 13 i Ligjit nuk kufizohet vetëm në popullata të përkufizuara në bazë të shtetësisë, përkatësisë etnike të përbashkët apo prej karakteristikave të tjera dalluese të ngjashme, dhe ai mund të përfshijë edhe popullatën e vetë shtetit.⁶⁸ Për të vlerësuar nëse sulmi ishte drejtuar kundër

⁶³ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 90; *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 77.

⁶⁴ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 90; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3026; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 303; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1105.

⁶⁵ Duke marrë parasysh nenin e përbashkët 3 dhe nenet 43 dhe 50 të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe në Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokollit I) të 8 qershorit 1977 (“Protokollit Shtesë I”), ndër personat që nuk marrin pjesë në luftime përfshihen edhe anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, apo çfarëdo shkakut tjetër, si edhe anëtarë të një lëvizjeje të rezistencës dhe ish-luftëtarë që nuk merrnin më pjesë në luftime në kohën kur u kryen krimet. Shih, për shembull, ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 425; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“*Blaškić Trial Judgment*”), 3 mars 2000, para. 214; *Prosecutor v. Limaj et al.*, IT-03-66-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“*Limaj et al. Trial Judgment*”/Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*), para. 186; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3027; ICTR/TPNR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 582; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 311; *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 78; [Katanga Trial Judgment](#), 7 mars 2014, para. 1102.

⁶⁶ ICTY/TPNJ, [Blagojević and Jokić Trial Judgment](#), para. 544; ICTR/TPNR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 582. Shih gjithashtu nenin 50(3) të Protokollit Shtesë I.

⁶⁷ SCSL, *Prosecutor v. Moinina Fofana, Allieu Kondewa*, SCSL-04-14-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 maj 2008, para. 299, 300.

⁶⁸ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-T, Trial Chamber, [Opinion and Judgment](#) (“*Tadić Trial Judgment*”), 7 maj 1997, para. 635; [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 423; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial](#)

popullatës civile, mund të merren parasysh, ndër të tjera, (i) mjetet dhe metodat e përdorura gjatë sulmit; (ii) statusi i viktimave dhe numri i tyre; (iii) karakteri diskriminues i sulmit; (iv) lloji i krimeve të kryera gjatë sulmit; (v) forma e qëndresës ndaj sulmuesve në kohën e sulmit; (vi) shkalla në të cilën forca sulmuese zbatoi kriteret parandaluese të ligjeve të luftës; dhe (vii) propaganda dhe stërviçja e trupave lidhur me sulmet e drejtuara kundër civilëve.⁶⁹

54. *I përhapur gjerësisht ose sistematik*. Lloji i sulmit karakterizohet nga cilësimet veçuese “i përhapur gjerësisht” ose “sistematik”.⁷⁰ Shprehja “i përhapur gjerësisht” nënkupton shtrirjen e gjerë të sulmit dhe numrin e personave të sulmuar.⁷¹ Ajo mund të nënkuptojë një sulm të kryer në një zonë të madhe gjeografike, ose një sulm të kryer në një zonë të vogël gjeografike drejtuar kundër një numri të madh civilësh.⁷² Termi “sistematik” ka të bëjë me karakterin e organizuar të veprimeve të dhunës dhe pamundësinë që ato të kenë ndodhur rastësisht. Rregullsia në kryerjen e krimeve, në kuptimin e përsëritjes jorastësore dhe të rregullt të veprimeve kriminale të ngjashme, është shprehje e zakonshme e kryerjes sistematike të tyre.⁷³ Ekzistenca e një politike ose plani mund të jetë tregues i karakterit sistematik të sulmit, por nuk përbën një element juridik më

[Judgment](#), para. 312; ICC/GJPN, [Katanga Trial Judgment](#), para. 1103; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06, Trial Chamber VI, [Judgment](#) (“Ntaganda Trial Judgment”), para. 667.

⁶⁹ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 91; *Prosecutor v. Mrkšić and Šljivančanin*, IT-95-13/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment”), 5 maj 2009, para. 30; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 309; ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 671.

⁷⁰ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 97; ICC/GJPN, *Situation in the Republic of Kenya*, ICC-01/09-19-Corr, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 15 of the Rome Statute on the Authorisation of an investigation into the Situation in the Republic of Kenya](#), para. 94.

⁷¹ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 94; [Mladić Trial Judgment](#)/Akgjykimi Mlladiq, para. 3025; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-717, Pre-Trial Chamber I, [Decision on Confirmation of Charges](#), para. 394; *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-656-Red, Pre-Trial Chamber I, *Gbagbo Decision on Confirmation of Charges*, para. 222.

⁷² ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 395; *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 83.

⁷³ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 94; *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Kordić and Čerkez Appeal Judgment”), 17 dhjetor 2004, para. 94; ICTR/TPNR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 580; ICC/GJPN, [Gbagbo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 223.

vete.⁷⁴ Për të përcaktuar nëse një sulm është “i përhapur gjerësisht” ose “sistematik”, mund të merren parasysh, ndër të tjera, (i) pjesëmarrja e mundshme e zyrtarëve ose autoriteteve, ose çfarëdo praktike e identifikueshme krimesh;⁷⁵ (ii) përsëritja e veprimeve diskriminuese të drejtuara kundër disa pjesëtarëve të caktuar të popullatës;⁷⁶ (iii) përdorimi i propagandës nga kryesit;⁷⁷ dhe (iv) pasojat e sulmit mbi popullatën e sulmuar.⁷⁸

(ii) Lidhja midis krimit bazë dhe sulmit

55. Krimi bazë duhet të kryhet “si pjesë e” sulmit kundër popullatës civile, por nuk është e nevojshme të kryhet gjatë vetë sulmit. Një krim që kryhet para ose pas sulmit kryesor kundër popullatës civile, ose larg tij, mund të jetë gjithsesi pjesë e atij sulmi në qoftë se ekziston lidhje e mjaftueshme midis tij dhe sulmit.⁷⁹ Për të përcaktuar ekzistencën e kësaj lidhjeje, duhen marrë parasysh karakteristikat, qëllimet, lloji ose pasojat e krimit.⁸⁰

(iii) Dijenja për sulmin

56. Kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm se po kryhet një sulm i përhapur gjerësisht ose sistematik kundër një popullate civile dhe se veprimet e tij janë pjesë e atij sulmi, ose së paku, duhet të ketë ndërmarrë rrezikun që veprimet e tij te kenë qenë

⁷⁴ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 98; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3025; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 312, ICC/GJPN, [Katanga Trial Judgment](#), para. 301.

⁷⁵ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 95.

⁷⁶ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“*Krajišnik Trial Judgment*”), 27 shtator 2006, para. 708.

⁷⁷ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 572.

⁷⁸ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 95.

⁷⁹ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 100; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 318.

⁸⁰ ICC/GJPN, *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 86; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1124.

pjesë e sulmit.⁸¹ Nuk është e nevojshme që kryesi t'i dijë hollësitë e sulmit, apo të ketë të njëjtin qëllim ose synim si sulmi. Gjithashtu, nuk ka rëndësi nëse kryesi synonte që veprimet e tij të drejtoheshin kundër popullatës që ishte objekt i sulmit, apo thjesht kundër viktimës.⁸² Dijenia e kryesit mund të deduktohet ndër të tjera nga (i) pozita e kryesit në hierarkinë ushtarake dhe roli i tij në fushatën kriminale; (ii) prania e kryesit në vendin e kryerjes së krimit; dhe (iii) rrethanat e përgjithshme historike dhe politike në të cilat u kryen veprimet.⁸³

(b) Kriteret konkrete lidhur me krimet kundër njerëzimit

(i) *Burgosja*

57. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i burgosjes si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(e) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton heqjen e lirisë së një personi pa proces ligjor të rregullt, që e bën burgosjen arbitrare.⁸⁴ Burgosja përfshin mbajtjen e paligjshme të një personi në një mjedis të mbyllur, si për shembull burg ose institucion psikiatrik, dhe kufizimin e paligjshëm të lëvizjeve të atij personi brenda një hapësire të caktuar, si për shembull në një geto, kamp apo shtëpi.⁸⁵

⁸¹ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 102; *Prosecutor v. Šainović et al.*, IT-05-87-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“Šainović et al. Appeal Judgment”)/Aktgjykimi i Apelit *Shainović dhe të tjerë*, 23 janar 2014, para. 271; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3029; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 319; ICC/GJPN, *Bemba Decision on Confirmation of Charges*, para. 87, 88.

⁸² ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 102, 103; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 319; ICC/GJPN, [Katanga Trial Judgment](#), para. 1125.

⁸³ ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 402.

⁸⁴ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“Kordić and Čerkez Trial Judgment”), 26 shkurt 2001, para. 302; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“Krnojelac Trial Judgment”), 15 mars 2002, paras 113-115; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 116; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 347; *Co-Prosecutors v. Nuon Chea and Khieu Samphan*, 002/19-09-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Case 002/02 Judgment](#) (“Case 002/02 Trial Judgment”), 16 nëntor 2018, para. 689; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-T, Trial Chamber, [Judgment and Sentence](#) (“Ntagerura Trial Judgment”), 25 shkurt 2004, para. 702.

⁸⁵ ICC/GJPN, *Situation in the Republic of Burundi*, ICC-01/17-9-Red, Pre-Trial Chamber III, [Public Redacted Version of “Decision Pursuant to Article 15 of the Rome Statute on the Authorization of an Investigation into](#)

58. Heqja e lirisë konsiderohet arbitrare kur nuk ekziston bazë ligjore për përligjen e saj. Nëse qoftë se baza ligjore për burgosjen ekziston, ajo duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së burgimit; në momentin që baza ligjore pushon së ekzistuari, vazhdimi i mbajtjes në burgim mund të konsiderohet arbitrar.⁸⁶ Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përmbajnë udhëzime që ndihmojnë në kryerjen e vlerësimit nëse heqja e lirisë është arbitrare.⁸⁷ Në qoftë se përligjja e burgosjes bëhet mbi bazën e legjislacionit shtetëror, atëherë duhet të vërtetohet që dispozitat përkatëse nuk janë në shkelje të së drejtës ndërkombëtare.⁸⁸

59. Arbitrariteti i burgosjes mund të rrjedhë edhe nga heqja e lirisë fizike, e cila përndryshe do të ishte e përligjur, në qoftë se heqja e lirisë bëhet në mosrespektim të rëndë të të drejtave procedurale themelore, të parapara në të drejtën ndërkombëtare, të personit të cilit i është hequr liria.⁸⁹ Të drejtat procedurale themelore përfshijnë, në veçanti: (i) të drejtën për t'u informuar për arsyen e

[the Situation in the Republic of Burundi, ICC-01/17-9-US-Exp, 25 October 2017](#) ("Burundi Decision 25 October 2017"), para. 68; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-A, Appeals Chamber, [Judgement Volume 1 Part 2](#) ("Prlić et al. Appeal Judgment"), 29 nëntor 2017, para. 473; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 640; *Prosecutor v. Simić et al.*, IT-95-17/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#) ("Simić et al Trial Judgment"), 17 tetor 2003, para. 534, 661; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 464, 468; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 1160-1163.

⁸⁶ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 114; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 348; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 689, 691; ICTR/TPNR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 702.

⁸⁷ Për shembull, shih nenet 9 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (GA/RES/217 A/(III) të 10 dhjetorit 1948); nenet 5 dhe 6 të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (UNTS vëll. 213, f. 221); nenet 9 dhe 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (UNTS vëll. 999, f. 171); dhe Tërësia e Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave ndaj të cilëve zbatohet çfarëdo forme ndalimi ose burgimi (GA Res. 43/173 e 9 dhjetorit 1999). ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 113; ECCC/DHJGJK, [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 692-693; ICC/GJPN, *Burundi Decision 25 October 2017*, poshtëshënimi 169.

⁸⁸ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 114; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 348; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para 689; ICTR/TPNR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 702.

⁸⁹ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), poshtëshënimi 347; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 302; ICTR/TPNR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 702.

ndalimit; dhe (ii) të drejtën për shqyrtim të shpejtë të ligjshmërisë së ndalimit prej një gjykate ose paneli administrativ.⁹⁰

60. Ligji nuk kërkon që burgosja të jetë për një periudhë të zgjatur. Vetëm koha e shkurtër e ndalimit nuk mund të paraqitet si argument për të mohuar shkallën ose peshën e heqjes së lirisë fizike.⁹¹ Megjithatë, jo çdo heqje e vogël lirie i përmbush elementet materiale të burgosjes.⁹²

61. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet të ketë pasur qëllimin për heqjen e lirisë fizike të personit, ose ka vepruar duke pasur dijeninë e arsyeshme se veprimi ose mosveprimi i tij ka gjasa të shkaktojë heqjen arbitrare të lirisë fizike të personit.⁹³

(ii) *Akte të tjera çnjerëzore*

62. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i akteve të tjera çnjerëzore si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(j) të Ligjit, kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi me peshë të ngjashme me atë të akteve të tjera të renditura në nenin 13 të Ligjit, i cili shkakton vuajtje apo lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose përbën cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.⁹⁴ Sikurse sugjerohet edhe

⁹⁰ ICTY/TPNJ, [Krnjelac Trial Judgment](#), para. 120; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-T, Trial Chamber, [Judgement Volume 1](#), (“Prlić et al. Trial Judgment”), 29 maj 2013, para. 66; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 239.

⁹¹ ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 October 2017](#), para. 68.

⁹² ICTR/TPNR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 702; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 349.

⁹³ ICTY/TPNJ, [Krnjelac Trial Judgment](#), para. 115; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 350; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 687.

⁹⁴ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Popović et al. Trial Judgment”), 10 qershor 2010, para. 888; *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“Vasiljević Trial Judgment”), 29 nëntor 2002, para. 234; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-T, Trial Chamber, [Judgement and Sentence](#) (“Bagosora et al. Trial Judgment”), 18 dhjetor 2008, para. 2218; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 368.

nga termi “të tjera”, ky është një krim plotësues i cili penalizohet si sjellje që nuk përfshihet në ndonjë prej krimeve të tjera të renditura në nenin 13 të Ligjit.⁹⁵

63. Formulimi i nenit 13(1)(j) të Ligjit është i hapur dhe lejon përfshirjen e një vargu veprimesh dhe mosveprimesh. Për të mos lejuar shkelje të mundshme të parimit *nullum crimen sine lege*, zbatueshmëria e tij duhet të kufizohet për veprime të rënda që kanë të njëjtën peshë si edhe krimet e tjera të paraqitura në nenin 13 të Ligjit.⁹⁶ Shkalla e ashpërsisë së veprimeve duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke u kushtuar vëmendjen e duhur rrethanave konkrete në secilën çështje gjyqësore,⁹⁷ si: (i) lloji i veprimit ose mosveprimit; (ii) konteksti në të cilin ka ndodhur; (iii) rrethanat personale të viktimës, ndër të cilat mosha, gjinia dhe gjendja shëndetësore; dhe (iv) ndikimi fizik, mendor dhe moral i sjelljes mbi viktimën.⁹⁸ Ndalimi ose izolimi i personave në kushte çnjerëzore mund të përbëjë akt

⁹⁵ Në mënyrë të ngjashme, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), (“*Kvočka et al. Trial Judgment*”), 2 nëntor 2001, para. 206; [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 234; ICTR/TPNR, [Bagosora et al. Trial Judgment](#), para. 2218; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 367; ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 452; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-382-Red, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute](#), 23 janar 2012, para. 269; *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-461-Corr-Red, Pre-Trial Chamber I, [Rectificatif à la Décision relative à la confirmation des charges portées contre Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud](#), (“*Al Hassan Decision on Confirmation of Charges*”), 13 nëntor 2019, para. 252.

⁹⁶ Në mënyrë të ngjashme, ICTY/TPNJ, [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 117; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 206; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Niyitegeka*, ICTR-96-14-T, Trial Chamber, [Judgement and Sentence](#), 16 maj 2003, para. 460; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 367; ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 448. Përfundimi nëse një sjellje e caktuar përmbush standardin e ashpërsisë mund të nxirret edhe në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti në bazë të KEDNJ-së dhe KNDCP-së. *Shih* ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Judgement](#), (“*Kupreškić et al. Trial Judgment*”), 14 janar 2000, para. 566; ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 449; [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 252.

⁹⁷ ICTY/TPNJ, [Blaškić Trial Judgment](#), para. 243; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 117; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 369; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 253.

⁹⁸ ICTY/TPNJ, [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 235; ECCC/DHJGJK, *Co-Prosecutors v. Nuon Chea and Khieu Samphan*, 002/19-09-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Case 002/01 Judgment](#), 7 gusht 2014, para. 438; ICC/GJPN, [Katanga and Ngudjolo Decision on Confirmation of Charges](#), para. 449.

çnjërzor në rrethana të caktuara,⁹⁹ por nuk përbën thjesht në vetvete një akt çnjërzor.

64. Nuk është e nevojshme që vuajtja të ketë pasoja afatgjata, megjithëse kjo mund të ketë rëndësi për përcaktimin e shkallës së ashpërsisë së veprimeve kriminale.¹⁰⁰

65. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Veprimi ose mosveprimi duhet të jenë kryer qëllimisht ose me dijeninë se ky veprim ose mosveprim mund të shkaktoje këtë dhimbje ose vuajtje ose mund të përbënte cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.¹⁰¹

(iii) *Tortura*

66. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i torturës si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(f) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton dhimbje ose vuajtje të rëndë fizike apo mendore mbi një person tjetër.¹⁰²

67. Analiza nëse veprimi apo mosveprimi i përmbush kriteret e aktit të torturës duhet të bëhet rast pas rasti,¹⁰³ duke marrë parasysh, për shembull: (i) llojin dhe rrethanat e shkaktoimit të dhimbjes; (ii) paramendimin dhe institucionalizimin e keqtrajtimit; (iii) gjendjen fizike të viktimës; (iv) mënyrën dhe metodën e përdorur; (v) pozitën inferiore të viktimës; (vi) shkallën në të cilën është

⁹⁹ ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Bagilishema*, ICTR-95-IA-T, Trial Chamber, *Judgement*, 7 qershor 2001, para. 490-492.

¹⁰⁰ ICTY/TPNJ, [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 235; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 369; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 253.

¹⁰¹ ICTY/TPNJ, [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 236; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 888; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-T, Trial Chamber, *Judgement*, 21 maj 1999, para. 153.

¹⁰² ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-T, Trial Chamber, *Judgement* ("Brđanin Trial Judgment"), 1 shtator 2004, para. 481; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 142; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 354.

¹⁰³ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Appeals Chamber, *Judgement* ("Brđanin Appeal Judgment"), 3 prill 2007, para. 251; *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-A, Appeals Chamber, *Judgement* ("Naletilić and Martinović Appeal Judgment"), 3 maj 2006, para. 299; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 149.

keqtrajtuar personi gjatë një periudhe të zgjatur; (vii) përdorimin e formave të përsëritura ose të ndryshme të keqtrajtimit që janë të ndërlidhura, kryhen sipas një praktike të caktuar veprimesh, ose bëhen për arritjen e të njëjtit qëllim të ndaluar.¹⁰⁴ Kushtet e imponuara gjatë ndalimit, si rrahjet, dhuna seksuale, lënia për një kohë të gjatë pa gjumë, ushqim, higjienë dhe ndihmë mjekësore, si dhe kërcënimet me torturë, përdhunim, ose vrasje të të afërmeve, janë konsideruar të rënda në atë masë sa të përbëjnë torturë.¹⁰⁵

68. Gjithashtu, nuk është e nevojshme që pasojat e veprimit ose mosveprimit të jenë të dukshme apo të përhershme të viktimave.¹⁰⁶ Nuk është kusht që kryesi të ketë vepruar në cilësinë e një zyrtari publik apo si person me pushtet.¹⁰⁷

69. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhimbjen dhe vuajtjen në mënyrë të qëllimshme dhe me synime të tilla si marrja e informatave apo e një deklaratë pranuese; ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi apo diskriminimi i viktimës ose një personi të tretë, për çfarëdo arsye.¹⁰⁸ Është e mjaftueshme që një nga qëllimet e ndaluara të jetë pjesë e motivit për sjelljen; nuk është e nevojshme që ai të jetë “qëllimi mbizotërues ose i vetëm” në shkaktimin e dhimbjes apo vuajtjes së rëndë.¹⁰⁹

¹⁰⁴ ICTY/TPNJ, [Simić et al. Trial Judgment](#), para. 80, i referohet [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 182. *Shih gjithashtu* [ECCC/DHJGJK, Duch Trial Judgment](#), para. 355.

¹⁰⁵ ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 355, i referohet ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“*Mucić et al. Trial Judgment*”), 16 nëntor 1998, para. 467; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 151; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 150.

¹⁰⁶ ICTY/TPNJ, [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 148; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 355.

¹⁰⁷ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 148; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“*Kvočka et al. Appeal Judgment*”), 28 shkurt 2005, para. 284.

¹⁰⁸ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 153; *Limaj et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë*, 30 nëntor 2005, para. 235, 239; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 356.

¹⁰⁹ ICTY/TPNJ, [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 153; [Mucić et al. Trial Judgment](#), 16 nëntor 1998, para. 470; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 155; [Simić et al. Trial Judgment](#), para. 81; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 356.

(iv) Vrasja e paligjshme

70. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i vrasjes së paligjshme si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(a) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton vdekjen e një personi.¹¹⁰ Nuk është e nevojshme të tregohet kufoma e personit të ndjerë si provë e vdekjes; mjafton mbështetja në prova rrethore,¹¹¹ duke marrë parasysh, për shembull: (i) raste të keqtrajtimit të viktimës; (ii) praktika të keqtrajtimit ose zhdukjes së viktimave të tjera; (iii) përkimi, ose përkimi i afërt i kohës së vdekjes së viktimave të tjera; (iv) rrethanat në të cilat viktimat është parë për herë të fundit; (v) atmosfera e përgjithshme e moszbatimit të ligjit në zonën ku u kryen aktet dhe sjellja e përgjithshme e ushtarëve aty afër; dhe (vi) koha që ka kaluar që prej zhdukjes së personit.¹¹²

71. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet ta ketë vrarë personin në mënyrë të qëllimshme, ose të ketë shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik, që kryesi logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të shkaktonte vdekje.¹¹³

(v) Zhdukje me forcë e personave

72. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i zhdukjes me forcë të personave si krim kundër njerëzimit,¹¹⁴ brenda kuptimit të nenit 13(1)(i) të Ligjit, kryhet nga

¹¹⁰ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 324; [Krajišnik Trial Judgment](#), para. 715; ICTR/TPNR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 589; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 331; ICC/GJPN, [Bemba Decision on Confirmation of Charges](#), para. 132.

¹¹¹ ICTY/TPNJ, [Tadić Trial Judgment](#), para. 240; ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 326; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 446; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 332; ICC/GJPN, [Katanga Trial Judgment](#), para. 768.

¹¹² ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 327; *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Halilović Trial Judgment”), 16 nëntor 2005, para. 37.

¹¹³ ICTY/TPNJ, [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 236; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3050; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 333.

¹¹⁴ Krimi i zhdukjes me forcë si krim kundër njerëzimit është njohur në disa instrumente ligjore, si në: Organisation of American States, *Annual Report of the Inter-American Commission on Human Rights*,

përfaqësues shtetërorë ose persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose pëlqimin e heshtur të shtetit ose të një organizate politike,¹¹⁵ përmes një veprimi apo mosveprimi që çon në heqjen e lirisë së një personi, ndjekur nga refuzimi për

AG/RES.666 (XIII-01/83), 18 nëntor 1983, para. 4; *Declaration on the Protection of All Persons from Enforced Disappearance*, A/RES/47/133, miratuar më 18 dhjetor 1992 (“1992 Declaration”), paragrafi i katërt i hyrjes; *Inter-American Convention on Forced Disappearance of Persons*, 9 qershor 1994, *OAS Treaty Series No. 68*, f. 33 (“1994 Inter-American Convention”), paragrafi i gjashtë i hyrjes; International Law Commission, *Draft Code of Crimes Against the Peace of Mankind*, Yearbook ILC, 1996, vol. II (Part Two), f. 50; neni 7(1)(i) i Statutit të Romës, 17 korrik 1998, UNTS, vëll. 2187 (“Statuti i Romës”), f. 3; neni 5.1(i) dhe 5.2(h) i *Regulation No. 2000/15 on the Establishment of Panels with Exclusive Jurisdiction Over Serious Criminal Offences*, UNTAET/REG/2000/15, 6 qershor 2000; *Report of the Intersessional Open-Ended Working Group to Elaborate a Draft Legally Binding Normative Instrument for the Protection of All Persons from Enforced Disappearance*, E/CN.4/2005/66, 10 mars 2005 (“2005 ISWG Report”), para. 12; *International Convention for the Protection of All Persons from Enforced Disappearance*, UNTS, vol. 2716, f. 3 (“2006 Convention on Enforced Disappearance”), paragrafi i pestë i hyrjes dhe neni 5; *Draft Articles on Prevention and Punishment of Crimes Against Humanity* (“CAH Draft Articles”), neni 2(1)(i), pjesë e Raportit të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare (2019), A/74/10, f. 10-140.

¹¹⁵ Për përcaktimin e përgjegjësisë penale në lidhje me krimin kundër njerëzimit të zhdukjes me forcë, kryesit mund të veprojnë në kontekstin e shtetit ose të një organizate politike. Kjo është pranuar në ECCC/DHJGJK, [Case 002/01 Trial Judgment](#), para. 448; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 754; neni 7(2)(i) i Statutit të Romës dhe elementet e krimeve të lidhura me të; neni 2(2)(i) i *CAH Draft Articles*; ky element është mbështetur në raportin me titull “*Civil and Political Rights, Including Questions of: Disappearances and Summary Executions*”, i z. Manfred Nowak (“2002 Nowak Report”), E/CN.4/2002/71, 8 janar 2002, para. 71, 73; Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, *Resolution 1463* (2005), 3 tetor 2005, para. 10.1.1 (ku bëhet thirrje për një përkufizim të gjerë të zhdukjes me forcë që përfshin veprime “të kryera nga aktorë joshitetërorë, si grupe paramilitare, skuadra të vdekjes, luftëtarë rebelë, ose grupe të krimit të organizuar”). Përfshirja e shtetit theksohet gjithashtu edhe në shumë instrumente të drejtave të njeriut, si GA/RES/33/173 (“Personat e Zhdukur”), 20 dhjetor 1978, paragrafët 2-4 të hyrjes; *1992 Declaration*, para. 3 i hyrjes; neni II i *1994 Inter-American Convention*; neni 2 i *2006 Convention on Enforced Disappearance* (neni 3 i kësaj Konvente i lejon shtetet të hetojnë raste të zhdukjeve me forcë të kryera nga persona ose grupe personash që veprojnë pa autorizimin, mbështetjen, ose pëlqimin e shtetit); *Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances* (“1987 WGEID Report”), E/CN.4/1988/19, 31 dhjetor 1987, para. 17; *Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances* (“1996 WGEID Report”), E/CN.4/1996/38, 15 janar 1996, para. 55; *Addendum to the Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances* (“2010 WGEID Report Addendum”), A/HRC/16/48/Add.3, 28 dhjetor 2010, para. 25-26 (ku megjithatë pranohet që përkufizimi në Statutin e Romës të zgjerohet për të përfshirë edhe “organizatat politike”); Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, *Rezoluta 828* (1984), para. 2. *Shih edhe* *Inter-American Court of Human Rights* (“IACtHR”), *Case of Velásquez-Rodríguez v. Honduras*, [Judgment \(Merits\)](#) (“*Velásquez-Rodríguez v. Honduras Judgment*”), 29 korrik 1988, para. 148; *Case of Gómez-Palomino v. Peru, Order (Monitoring compliance with Judgment)* (*Gómez-Palomino v. Peru Order*), 22 nëntor 2005, para. 97; *Case of the Río Negro Massacres v. Guatemala*, [Judgment \(Preliminary objection, merits, reparations and costs\)](#), 4 shtator 2012, para. 115; *Case of Osario Rivera and Family Members v. Peru*, [Judgment](#), 26 nëntor 2013, para. 113.

të pranuar se ka pasur heqje lirie apo për të dhënë informacion lidhur me fatin ose vendndodhjen e atij personi.¹¹⁶

73. Heqja e lirisë përfshin të gjitha format e heqjes së lirisë së një personi kundër vullnetit të tij ose të saj, në çfarëdo vendi.¹¹⁷ Heqja e lirisë në vetvete mund të jetë që në fillim e paligjshme, ose edhe nëse fillimisht e justifikueshme, mund të bëhet në vijim e paligjshme.¹¹⁸ Ajo përfshin gjithashtu edhe rastin kur personi në fjalë fillimisht është arrestuar dhe mbajtur i ndaluar në mënyrë të ligjshme, por në vijim “është zhdukur” gjatë ndalimit.¹¹⁹

¹¹⁶ Elementet e krimit rrjedhin nga e drejta zakonore ndërkombëtare e pasqyruar në instrumentet ligjore dhe praktikën e gjykatave ndërkombëtare, ndër të cilat edhe organet e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh dallimin ndërmjet shkeljeve të obligimeve lidhur me të drejtat e njeriut dhe përgjegjësisë penale, që pasqyrohet prej llojit të instrumenteve dhe mandateve konkrete të gjykatave ose organeve në vendimet e të cilave është mbështetur. Dokumentet, instrumentet dhe vendimet lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur pas juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara janë dëshmi e konsolidimit të përkufizimeve të mëparshme të zhdukjes me forcë. ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-T, Trial Chamber, [Judgement](#) 15 prill 2011, para. 1837; ECCC/DHJGJK, [Case 002/01 Trial Judgment](#), para. 448; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 754; Dhome Gjyqësore e Krimeve të Luftës në Gjykatën e Bosnje-Hercegovinës, *Boban Šimšić*, X-KR-05/04, [Verdict](#), 11 korrik 2006, para. 77; *Dragan Damjanović*, X-KR-05/51, [Verdict](#), 15 dhjetor 2006, f. 26-27; *Želko Lelek*, X-KR-06/202, [Verdict](#), 23 maj 2008, f. 26; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118; IACtHR, *Case of García and Family Members v. Guatemala*, Serie C No. 258, [Judgment](#) (“*García and Family Members v. Guatemala Judgment*”), 29 nëntor 2012, para. 115; *Case of González Medina and Family v. Dominican Republic*, [Judgment](#), 27 shkurt 2012, para. 128; 1987 WGEID Report, para. 17; 1996 WGEID Report, para. 55; paragrafi i tretë i hyrjes së 1992 Declaration, A/RES/47/133, miratuar më 18 dhjetor 1992; neni II i 1994 Inter-American Convention; neni 2 i 2006 Convention on Enforced Disappearance; neni 7(2)(i) i Statutit të Romës (që mbështetet në një masë të madhe në përkufizimin e 1992 Declaration) dhe neni 2(2)(i) i CAH Draft Articles.

¹¹⁷ *Shih më lart* para. 57-61 (Kritere të veçanta, Burgimi). ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118; paragrafi i tretë i hyrjes së 1992 Declaration (“personat arrestohen, ndalohen ose rrëmbehen kundër vullnetit të tyre, ose iu hiqet liria në ndonjë mënyrë tjetër”); neni II i 1994 Inter-American Convention (“akt i privimit të personit ose personave nga liria, në cilëndo mënyrë”); neni 7(2)(i) i Statutit të Romës (“arrestimi, ndalimi ose rrëmbimi i personave”), së bashku me Elementet e Krimeve (para. 1) dhe poshtëshënimet 25 dhe 26; neni 2(2)(i) CAH Draft Articles; neni 2 i 2006 Convention on Enforced Disappearance (“arrestimi, ndalimi, rrëmbimi ose çfarëdo forme tjetër e privimit nga liria”); Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances, A/HRC/7/2, 10 janar 2008 (“2007 WGEID Report”), f. 11, para. 7 (pjesë e Komentit të Përgjithshëm); 2010 WGEID Report Addendum, para. 22-24.

¹¹⁸ *Shih më lart*, para. 57-61 (Kritere të veçanta: Burgosja). *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 25 në pjesën e elementëve të krimeve të Statutit të Romës.

¹¹⁹ IACtHR, *Case of Trujillo-Oroza v. Bolivia*, [Judgment](#), 26 janar 2000; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118. *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 26 në pjesën e elementëve të krimeve të Statutit të Romës.

74. Refuzimi për të pranuar ose për të dhënë informacion përfshin mohimin kategorik, dhënien e informacionit të rremë, ose mbajtjen të fshehtë të fatit ose vendndodhjes së viktimës.¹²⁰ Në këtë kontekst vërehet se, pavarësisht nëse familja e viktimës ka bërë ankesë zyrtare,¹²¹ shteti ka për detyrë të kryejë *ex officio* dhe pa vonesë një hetim të efektshëm për zhdukjen e viktimës;¹²² po kështu, organizata politike ka detyrimin që të japë llogari për personat e zhdukur dhe të informojë familjet për fatin ose vendndodhjen e tyre.¹²³

¹²⁰ ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118; 2010 WGEID Report Addendum, para. 28.

¹²¹ Neni 13(1) i 1992 Declaration (“Kurdo që ka arsye për të besuar se është kryer një zhdukje me forcë, shteti duhet t’ia referojë pa vonesë çështjen atij autoriteti për të kryer hetimin përkatës, edhe nëse nuk është bërë ankesë zyrtarisht”); e njëjta gjuhë përdoret edhe në nenin 12(2) të 2006 *Convention on Enforced Disappearance*; në mënyrë të ngjashme, ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118; IACtHR, [Velásquez-Rodríguez v. Honduras Judgment](#), para. 177; *Case of Zambrano Vélez et al. v. Ecuador*, [Judgment](#), 4 korrik 2007, para. 120; *Case of Heliodoro Portugal v. Panama*, [Judgment](#) (“*Heliodoro Portugal v. Panama Judgment*”), 12 August 2008, para. 145.

¹²² ECtHR/GJEDNJ, *Case of Kurt v. Turkey*, 15/1997/799/1002, [Judgment](#), 25 maj 1998, para. 124; *Case of Cyprus v. Turkey*, 25781/94, [Judgment](#), 10 maj 2001, para. 147-148; *Case of Timurtaş v. Turkey*, 23531/94, [Judgment](#), 13 qershor 2000, para. 89-90 dhe 103-105; *Case of Bazorkina v. Russia*, 69481/01, [Judgment](#), 27 korrik 2006, para. 117-125, 148; IACtHR, [Velásquez-Rodríguez v. Honduras Judgment](#), para. 174-177, 181; *Case of Blake v. Guatemala*, [Judgment \(Merits\)](#) (“*Blake v. Guatemala Judgment*”), 24 janar 1998, para. 66; [Heliodoro Portugal v. Panama Judgment](#), para. 144; [García and Family Members v. Guatemala Judgment](#), para. 138; Human Rights Committee, *Bleier v. Uruguay*, Communication No. 30/1978, Decision, 29 mars 1982, para. 15; *Quinteros Almeida v. Uruguay*, Communication No. 107/1981, Decision (“*Quinteros Decision*”), 21 korrik 1983, para. 15; *Arévalo Perez et al. v. Columbia*, Communication No. 181/1984, Decision, 3 nëntor 1989, para. 10; *Laureano Atachahua v. Peru*, Communication No. 540/1993, Decision, 25 mars 1996, para. 10; *Sarma v. Sri Lanka*, Communication No. 950/2000, Decision, 16 korrik 2003, para. 11; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 118. *Shih edhe nenin 13 të 1992 Declaration*; Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances, A/HRC/16/48 (“2010 WGEID Report”), 26 janar 2011, f. 14-15, para. 4-5 (pjesë e Komentit të Përgjithshëm).

¹²³ Ndalimi me ligj i zhdukjes me forcë në konflikte të armatosura ndërkombëtare ose jondërkombëtare, dhe detyrimi për të dhënë llogari për personat e zhdukur dhe për t’u dhënë familjeve të tyre çfarëdo informacioni për fatin e tyre, vlen për të gjitha palët në konflikt, përfshirë edhe grupet e armatosura, *shih* rregullat 98 dhe 117, *CIHL Study, Vol. I* (Rregullat), f. 340-343 dhe 421-427; Asambleja e Përgjithshme, “*Assistance and co-operation in accounting for persons who are missing or dead in armed conflicts*”, Resolution 3220 (XXIX), 6 nëntor 1974, neni 2 (“U bën thirrje palëve në konflikte të armatosura, pavarësisht nga karakteri i tyre apo vendet ku zhvillohen, që gjatë luftimeve dhe pas përfundimit të tyre dhe në përputhje me Konventat e Gjenevës të vitit 1949, të ndërmarrin çfarëdo veprimesh që përfshihen në kompetencat e tyre për të ndihmuar në gjetjen dhe shënimin e varreve të të vdekurve, të mundësojnë zvarrosjen dhe kthimin e kufomave, nëse kërkohet prej familjeve të tyre, dhe të japin informacion për ata që janë zhdukur gjatë veprimeve luftarake”). Nëse këto detyrime ekzistojnë për grupet e armatosura gjatë konfliktit, atëherë mund të pritët që ato ekzistojnë edhe jashtë konfliktit të armatosur, përfshirë edhe në kontekstin e një sulmi të përhapur gjerësisht ose sistematik.

75. Si rezultat i zhdukjes me forcë, viktima nxirret jashtë mbrojtjes së ligjit, domethënë viktima nuk ka më qasje në ndihmë gjyqësore dhe procedura juridike, duke u gjendur kështu pa kurrfarë mbrojtjeje.¹²⁴ Përkufizimi i zhdukjeve me forcë në të drejtën zakonore ndërkombëtare nuk përcakton një periudhë minimale të nxjerrjes së viktimës jashtë mbrojtjes së ligjit.¹²⁵

76. Krimi i zhdukjes me forcë konsiderohet krim që vazhdon për sa kohë që kryesit vazhdojnë të mbajnë të fshehur fatin dhe vendndodhjen e personit, ose personave që janë zhdukur dhe këto fakte mbeten të pasqaruara.¹²⁶

77. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet: (i) t'ia ketë hequr lirinë personit në mënyrë të qëllimshme dhe me vetëdijen se heqja e lirisë do të ndiqej nga refuzimi për të pranuar se është bërë heqje lirie ose për të dhënë informacion për fatin apo vendndodhjen e viktimës; ose (ii) të ketë refuzuar dhënien e informacionit për fatin ose vendndodhjen e personit në fjalë në mënyrë të

¹²⁴ Para. i tretë i hyrjes dhe neni 1(2) i 1992 *Declaration*; neni II i Konventës Ndëramerikane të vitit 1994; neni 2 i Konventës mbi Zhdukjet me Forcë e vitit 2006; Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Resolution 1463 (2005), 3 tetor 2005, para. 1; 2007 WGEID Report, f. 11, para. 5 (pjesë e Komentit të Përgjithshëm); 2010 WGEID Report Addendum, para. 29; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 120; IACtHR, *Caso Anzualdo Castro v. Peru*, [Sentencia \(Excepción Preliminar, Fondo, Reparaciones y Costas](#), 22 shtator 2009, para. 94-99; *Chitay Nech et al. v. Guatemala*, [Judgment \(Preliminary Objections, Merits, Reparations, and Costs\)](#), 25 maj 2010, para. 99-100. Nxjerrja e personit jashtë mbrojtjes së ligjit shkel zakonisht dhe në veçanti të drejtën për liri vetjake, *shih* neni 5 të KEDNJ-së; neni 9 i KNDCP-së të vitit 1966; neni XI i 1994 *Inter-American Convention*; neni 17 i Konventës së vitit 2006 mbi Zhdukjet me Forcë.

¹²⁵ Përkufizimet e konceptit të zhdukjes me forcë në instrumentet juridike ndërkombëtare nuk përfshijnë kriterin kohor. *Shih edhe* 2007 WGEID Report, f. 12, para. 8-9 (pjesë e Komentit të Përgjithshëm).

¹²⁶ Neni 17(1) i 1992 *Declaration*; neni III-1 i Konventës Ndëramerikane të vitit 1994; neni 8(1)(b) i 2006 *Convention on Enforced Disappearance*; Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances, E/CN.4/2001/68, 18 dhjetor 2000, para. 25-32; 2010 WGEID Report, f. 11, para. 1 (pjesë e Komentit të Përgjithshëm); 2010 WGEID Report Addendum, para. 33; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 121; Human Rights Committee, *Quinteros Decision*, para. 14; ECtHR/GJEDNJ, *Case of El-Masri v. Former Republic of Macedonia*, 39630/09, [Judgment](#), 13 dhjetor 2012, para. 240; *Case of Varnava and Others v. Turkey*, 16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, [Judgment](#), 18 shtator 2009, para. 148; IACtHR, [Velásquez-Rodríguez v. Honduras Judgment](#), para. 155, 181; [Blake v. Guatemala Judgment](#), para. 65; *Case of Goiburú et al. v. Peru*, [Judgment \(Merits, Reparations and Costs\)](#), 22 shtator 2006, para. 81; [Heliodoro Portugal v. Panama Judgment](#), para. 34-35, 106-107; [García and Family Members v. Guatemala Judgment](#), para. 95, 112.

qëllimshme dhe i vetëdijshëm që ajo heqje lirie i parapriu ose e shoqëroi këtë refuzim.¹²⁷ Megjithatë, sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme në kohën përkatëse, nuk është e nevojshme të demonstrohet apo edhe të merret si i mirëqenë se kryesi kishte synimin e veçantë ta nxirrte viktimën jashtë mbrojtjes së ligjit.¹²⁸

(vi) Përndjekja

78. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i përndjekjes si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(h) të Ligjit kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi të paraqitur konkretisht në Aktakuzë¹²⁹, i cili faktikisht diskriminon, mohon ose shkel një të drejtë njerëzore themelore të paraparë në të drejtën zakonore ndërkombëtare apo të drejtën e traktateve ndërkombëtare.¹³⁰

79. Krimi i përndjekjes përbëhet nga një veprim ose mosveprim i vetëm apo një varg veprimesh ose mosveprimesh¹³¹ që: (i) ndalohen në bazë të cilësdo prej dispozitave të neneve 13 dhe 14 të Ligjit, si ndalimi/burgimi arbitrar, trajtimi

¹²⁷ Në mënyrë të ngjashme, para. 3 i nenit 7(1)(i) të Statutit të Romës mbi Elementet e Krimeve.

¹²⁸ Në mënyrë të ngjashme, 2002 Nowak Report, para. 69; Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Resolution 1463 (2005), 3 tetor 2005, para. 10.1.2; 2007 WGEID Report, f. 10; 2010 WGEID Report Addendum, para. 31; 2005 ISWG Report, para. 25.

¹²⁹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Appeal Judgement](#) (“*Kupreškić et al. Appeal Judgment*”), 23 tetor 2001, para. 98; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Blaškić Appeal Judgment*”), 29 korrik 2004, para. 139; *Prosecutor v. Stakić*, IT-97-24-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“*Stakić Trial Judgment*”), 31 korrik 2003, para. 735; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 965.

¹³⁰ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Krnojelac Appeal Judgment*”), 17 shtator 2003, para. 185; *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Vasiljević Appeal Judgment*”), 25 shkurt 2004, para. 113; *Prosecutor v. Simić*, IT-95-9-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Simić Appeal Judgment*”), 28 nëntor 2006, para. 177; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 497; *Mladić Trial Judgment*, para. 3228; ICTR/TPNR, [Bagosora et al. Trial Judgment](#), para. 2208; [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 985; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 376; *Co-Prosecutors v. Kaing Guek Eav*, 001/18-07-2007-ECCC/SC, Supreme Court Chamber, [Appeal Judgement](#) (“*Duch Appeal Judgment*”), 3 shkurt 2012, para. 257.

¹³¹ ICTY/TPNJ, [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 199; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 113; [Simić Appeal Judgment](#), para. 178; ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 258.

mizor, tortura, plaçkitja ose vrasja e paligjshme;¹³² ose që (ii) ndonëse nuk përmenden shprehimisht në to, kanë të njëjtën peshë si krimet e tjera të renditura në nenin 13 të Ligjit, qoftë kur shqyrtohen më vete apo së bashku me veprime të tjera bazë, në veçanti me ndikimin e gjithsejtë të tyre.¹³³ Ndër to përfshihen veprime si ngacmimi, poshtërimi, keqtrajtimi psikologjik, puna e detyruar ose masa të tjera kufizuese ose diskriminuese.¹³⁴ Nuk është e nevojshme që veprimi ose mosveprimi përndjekës të përbëjë krim në të drejtën ndërkombëtare ose shtetërore.¹³⁵

80. Jo çdo shkelje e të drejtave të njeriut që shkaktohet prej veprimit/veprimeve dhe mosveprimit/mosveprimeve përndjekëse është relevante, vetëm mohimi i rëndë i të drejtave themelore të një personi, domethënë mohimi i rëndë dhe i hapur i atyre të drejtave është relevant.¹³⁶ Të drejtat themelore shkelja e të cilave mund

¹³² ICTY/TPNJ, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), para. 594, 596, 600-605, 615(b), 617; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 198; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 185-186, 189; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 219; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 143, 147-148, 155; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 296; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 498, 502, 505, 509, 514, 521, 523-525, 527-529; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3229, 3231, 3234, 3240, 3253; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 378; [Duch Appeal Judgment](#), para. 253; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 668; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 994.

¹³³ ICTY/TPNJ, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), para. 615(e), 619, 622; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 195, 199; [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 434; [Stakić Trial Judgment](#), para. 736; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 321; [Simić Appeal Judgment](#), para. 177; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 296; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 499; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3229; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 985; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 378; [Duch Appeal Judgment](#), para. 254, 257-258; ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 992.

¹³⁴ ICTY/TPNJ, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), para. 594-605, 609-614, 615(c), 617; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 185-186, 190, 192; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 155; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 323, 325; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 296-297; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 498, 510, 523-525, 536; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3229, 3242-3244, 3264-3266; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 378; [Duch Appeal Judgment](#), para. 253-254; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 668.

¹³⁵ ICTY/TPNJ, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), para. 614; [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 434; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 323; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 296; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 966; [Mladić Trial Judgment](#), para. 3229; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 985; ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 261.

¹³⁶ ICTY/TPNJ, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), para. 620-621; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 196; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 966; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 378; [Duch Appeal Judgment](#), para. 258.

të përbëjë përndjekje gjenden në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut¹³⁷ dhe përfshijnë të drejtën për jetë, të drejtën për të mos u torturuar dhe trajtuar në mënyrë mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të drejtën për të mos u arrestuar ose mbajtur i ndaluar arbitrarisht, të drejtën për pronë private dhe të drejtën për gjykim të drejtë.¹³⁸ Me rëndësi është që personi nuk mundet t'i gëzojë këto të drejta, dhe është jothelbësore nëse shkelja u shkaktua nga shteti apo nga anëtarë të një grupi të armatosur joshtetëror.¹³⁹

81. Veprimi/veprimet ose mosveprimi/mosveprimet përndjekëse duhet të diskriminojnë faktikisht, që do të thotë se ato duhet të shkaktojnë faktikisht pasoja diskriminuuese.¹⁴⁰ Veprimi/veprimet ose mosveprimi/mosveprimet përndjekëse konsiderohen diskriminuuese kur viktimat vihen në shënjestër për shkak të përkatësisë së tyre të perceptuar në një grup, sipas mendimit të kryesit mbi baza politike, racore, etnike ose fetare.¹⁴¹ Ndonëse veprimet dhe/ose mosveprimet janë shpesh pjesë e një politike ose praktike diskriminuuese, ekzistenca e një politike të tillë nuk është kusht për të vërtetuar përndjekjen.¹⁴²

¹³⁷ *Shih p.sh.* Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ); Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP); Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (UNTS, vol. 993, f. 3) dhe KEDNJ.

¹³⁸ ICTY/TPNJ, [Blaškić Trial Judgment](#), para. 232; ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 254; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-309, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Bosco Ntaganda](#), 9 qershor 2014, para. 58; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 991; [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 132; [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 664.

¹³⁹ Në mënyrë të ngjashme, ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 993.

¹⁴⁰ ICTY/TPNJ, [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 113; [Simić Appeal Judgment](#), para. 177; [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 432; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 185; [Brđanin Trial Judgment](#), para. 993; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 986; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 376-377; [Duch Appeal Judgment](#), para. 263, 267.

¹⁴¹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-T, Trial Chamber, [Judgment](#) ("Naletilić and Martinović Trial Judgment"), 31 mars 2003, para. 636; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 967; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 377; [Duch Appeal Judgment](#), para. 272, 275-276; ICC/GJPN, [Burundi Decision 25 tetor 2017](#), para. 133; [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 665.

¹⁴² ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 435; [Stakić Trial Judgment](#), para. 739; [Brđanin Trial Judgment](#), para. 996; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 967; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 500.

82. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet ta ketë kryer çdo veprim apo mosveprim përndjekës¹⁴³ qëllimisht¹⁴⁴ dhe me synimin konkret për të diskriminuar mbi bazën e një prej arsyeve të renditura, konkretisht të arsyeve politike, racore, etnike ose fetare.¹⁴⁵ Kushti i ekzistencës së synimit diskriminues nuk është element ligjor i sulmit në përgjithësi¹⁴⁶ dhe as i krimeve të tjera bazë kundër njerëzimit.¹⁴⁷ Nuk është e nevojshme që ai të jetë synimi parësor i veprimit, por duhet të jetë një synim i rëndësishëm.¹⁴⁸ Motivet personale ose çfarëdo motivesh të tjera për arritjen e një qëllimi ushtarak nuk e përjashtojnë synimin diskriminues.¹⁴⁹

83. Synimi diskriminues mund të deduktohet nga provat rrethanore, duke marrë parasysh, për shembull, natyrën sistematike të krimeve të kryera kundër grupit të vënë në shënjestër dhe mënyrën e përgjithshme sesi vepron kryesi, sikurse demonstron nga sjellja e tij.¹⁵⁰

¹⁴³ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 436; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 184; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 164; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 969.

¹⁴⁴ ICTY/TPNJ, [Stakić Trial Judgment](#), para. 738; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 113; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Popović et al. Appeal Judgment*”), 30 janar 2015, para. 737; ICTR/TPNR, [Bagosora et al. Trial Judgment](#), para. 2208; [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 985; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 379; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 670.

¹⁴⁵ ICTY/TPNJ, [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 212; [Stakić Trial Judgment](#), para. 738; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 185; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 113; *Prosecutor v. Stakić*, IT-97-24-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Stakić Appeal Judgment*”), 22 mars 2006, para. 327-328; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 985; [Bagosora et al. Trial Judgment](#), para. 2208; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 379; [Duch Appeal Judgment](#), para. 236-240; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 671.

¹⁴⁶ ICTY/TPNJ, [Blaškić Trial Judgment](#), para. 260; [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 436.

¹⁴⁷ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Tadić Appeal Judgment*”), 15 korrik 1999, para. 305; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 500; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 379; [Duch Appeal Judgment](#), para. 238.

¹⁴⁸ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 435.

¹⁴⁹ ICTY/TPNJ, [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 463; [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 733; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 671.

¹⁵⁰ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 184; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 460; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 969; ICTR/TPNR, [Bagosora et al. Trial Judgment](#), para. 2208; ICC/GJPN, [Al Hassan Decision on Confirmation of Charges](#), para. 671.

2. Krimet e luftës

(a) Kriteret kontekstuale të krimeve të luftës

84. Kriteret kontekstuale të krimeve të luftës të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur me karakter jondërkombëtar përbëhen nga: (i) ekzistenca e një konflikti të armatosur me njëfarë intensiteti në territorin e një shteti, ndërmjet organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose mes grupeve të tilla; (ii) lidhja ndërmjet veprës penale bazë dhe konfliktit të armatosur, dhe (iii) dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur.

(i) Ekzistenca e konfliktit të armatosur

85. Neni 14(2) i Ligjit përcakton se konfliktet e armatosura me karakter jondërkombëtar ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur ndërmjet organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, apo mes grupeve të tilla.¹⁵¹

86. *Luftimet*. Konfliktet e armatosura karakterizohen nga shpërthimi i luftimeve që ndodhin në territorin e një shteti.

87. *Palët në luftime*. Në lidhje me palët në luftime, neni 14(2) i Ligjit përmend dy kategori të palëve të mundshme në konflikt të armatosur që duhet të interpretohen në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Në “organe të pushtetit” përfshihen autoritetet qeveritare, si forcat e rregullta të armatosura, njësitet e policisë, gardat kombëtare ose autoritete të tjera të ngjashme,¹⁵² ndër të cilat edhe

¹⁵¹ ICTY/TPNJ, *Tadić* Decision on Jurisdiction, para. 70; *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“*Bošković and Tarčulovski* Appeal Judgment”)/Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski, 19 maj 2010, para. 21. *Shih gjithashtu* ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 701; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2842, Trial Chamber I, [Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute](#) (“*Lubanga* Trial Judgment”), 14 mars 2012, para. 533.

¹⁵² ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (“*Bošković and Tarčulovski* Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski”), 10 korrik 2008, para. 178, 195.

grupet e armatosura dhe forca të mbrojtjes territoriale të përfshira në forcat e armatosura.¹⁵³ “Termi “grupe të armatosura të organizuara” nënkupton një shkallë organizimi, por “jo domosdoshmërisht duhet të jenë po aq të organizuara sa forcat e armatosura të një shteti”.¹⁵⁴ Nuk është e nevojshme që ato të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të bashkërenduara, por duhet të jenë mjaftueshmërisht të organizuara për t’u përballur me njëra-tjetrën me mjete ushtarake.¹⁵⁵ Në përcaktimin nëse një entitet joshtetëror mund të kryejë dhunë të armatosur për një kohë të zgjatur, mund të merren parasysh faktorët tregues të mëposhtëm: (i) ekzistenca e një strukture komanduese ku përfshihen ekzistenca e një selie të shtabit, e një shtabi të përgjithshëm ose komande të lartë, e gradave dhe posteve të identifikueshme, dhe e një rregulloreje të brendshme; (ii) lëshimi i deklaratave politike ose komunikatave dhe përdorimi i zëdhënësve; (iii) kapaciteti operativ dhe aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake; (iv) kapaciteti logjistik që përfshin disponueshmërinë e armëve dhe pajisjeve, si dhe kapaciteti për të lëvizur trupat dhe për të rekrutuar dhe stërvitur personelin; (v) kontrolli territorial që përfshin ndarjen në zona të përgjegjësisë; (vi) një sistem i brendshëm disiplinor që përfshin zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në radhët e grupit të armatosur; (vii) aftësia për të folur me një zë të vetëm në emër të grupit të armatosur, për shembull në negociata politike apo marrëveshje armëpushimi.¹⁵⁶

¹⁵³ Neni 43(3) i Protokollit Shtesë I.

¹⁵⁴ ICTY/TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçullovski, para. 195, 197; *Prosecutor v. Orić*, IT-03-68-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Orić Trial Judgment”), 30 qershor 2006, para. 254; *Prosecutor v. Haradinaj et al.*, IT-04-84-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Haradinaj et al. Trial Judgment”)/Aktgjykimi Haradinaj dhe të tjerë, 3 prill 2008, para. 60; *Limaj et al. Trial Judgment*/Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë, para. 89.

¹⁵⁵ ICTY/TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçullovski, para. 197-198.

¹⁵⁶ *Shih gjithashtu* neni 1(1) i Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gusht 1949, dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II), i 8 qershorit 1977 (“Protokolli Shtesë II”). *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçullovski, para. 194-203. Megjithatë, nuk është e nevojshme që shkalla e organizimit të një grupi të armatosur në një konflikt për të cilin është i zbatueshëm neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, të jetë në nivelin e organizimit të palëve në konfliktet e

88. *Intensiteti*. Në lidhje me nivelin e intensitetit të konfliktit, neni 14(2) i Ligjit kërkon që luftimet ndërmjet palëve duhet të arrijnë një shkallë të caktuar intensiteti që shkon përtej prishjes së rendit dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprimet e izoluara apo sporadike të dhunës, apo veprime të tjera të një natyre të ngjashme. Në këtë kontekst, nocioni i “dhunës së armatosur të zgjatur” shërben për përkufizimin e standardit të intensitetit, sepse i referohet “më tepër intensitetit të dhunës së armatosur sesa kohëzgjatjes së saj”.¹⁵⁷ Intensiteti mund të deduktohet, për shembull, nga: (i) ashpërsia dhe shpeshësia e sulmeve; (ii) përhapja e tyre në hapësirën territoriale dhe gjatë një periudhe, dhe nëse janë lëshuar urdhra armëpushimi; (iii) shtimi dhe numri i forcave të dislokuara; (iv) mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndër palët në konflikt; (v) lloji i armëve të përdorura, në veçanti përdorimi i artilerisë së rëndë; (vi) përdorimi i mjeteve luftarake, në veçanti përdorimi i tankeve; (vii) nëse situata ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave të tjera ndërkombëtare; (viii) pasojat mbi popullatën civile, shkalla e shkatërrimit dhe numri i personave të vrarë ose të zhvendosur; dhe (ix) mënyra si u trajtua grupi i armatosur nga të tjerët dhe cilat ishin ligjet sipas të cilave pretendonte se vepronte ky grup.¹⁵⁸

89. *Shtrirja*. Shtrirja kohore dhe gjeografike e konflikteve të armatosura me karakter jondërkombëtar duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të çështjes. Si rregull, ajo i kapërcen kufijtë e kohës dhe vendit të saktë të luftimeve; rregullat e zbatueshme veprojnë përtej pushimit të luftimeve deri në arritjen e një zgjidhjeje

armatosura për të cilat është i zbatueshëm Protokollin Shtesë II, *shih* ICTY/TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 197.

¹⁵⁷ ICTY/TPNJ, [Haradinaj et al. Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Haradinaj dhe të tjerë*, para. 49. *Shih gjithashtu Kordić and Čerkez Appeal Judgment*, para. 341; [Tadić Trial Judgment](#), para. 562.

¹⁵⁸ ICTY/TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 177, konfirmuar nga [Boškosi and Tarčulovski Appeal Judgment](#)/Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 22 and 24; ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 703-704, 716; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3343, Trial Chamber III, [Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute](#) (“*Bemba Trial Judgment*”), 21 mars 2016, para. 137; [Lubanga Trial Judgment](#), para. 538; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1186-1187.

paqësore.¹⁵⁹ Rrjedhimisht, normat e së drejtës humanitare ndërkombëtare janë të zbatueshme pavarësisht nëse faktikisht po ndodhin veprimtari luftarake në një vendndodhje të caktuar.¹⁶⁰ Nga ana tjetër, vetëm marrëveshjet për armëpushim ose marrëveshjet e tjera ndërmjet palëve nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar se konflikti i armatosur ka përfunduar. Përkundrazi, nëse konfrontimet e armatosura me një intensitet të caktuar vazhdojnë edhe pas arritjes së një marrëveshjeje për paqe (apo marrëveshjeje tjetër), konflikti i armatosur vazhdon të ekzistojë dhe rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare mbeten të zbatueshme¹⁶¹ deri kur të mos ketë konfrontime të armatosura për një kohë të gjatë dhe situata të jetë qetësuar mjaftueshëm, çka do të ishte e barabartë me një zgjidhje paqësore.¹⁶² Në rastin e personave të cilëve u është kufizuar liria, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet deri në momentin kur përfundon heqja apo kufizimi i lirisë.¹⁶³

(ii) *Lidhja me konfliktin e armatosur*

90. Krimet e pretenduara duhet të kenë lidhje të mjaftueshme me konfliktin e armatosur. Nuk është e nevojshme që konflikti i armatosur të ketë shkaktuar kryerjen e krimit për të cilin është ngritur akuzë, por ai duhet të ketë luajtur më së paku një rol të konsiderueshëm në aftësinë e kryesit për ta kryer atë krim, në vendimin e tij për ta kryer krimin, mënyrën sesi u krye krimi, ose qëllimin për të

¹⁵⁹ ICTY/TPNJ, [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 67-70; *Limaj et al.* Trial Judgment/Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 84; [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 25; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 57.

¹⁶⁰ ICTY/TPNJ, [Orić Trial Judgment](#), para. 255; [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 70.

¹⁶¹ ICTY/TPNJ, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 293; ICRC/KNKK, *Commentary on the Second Geneva Convention: Convention (II) for the Amelioration of the Condition of the Wounded, Sick and Shipwrecked Members of Armed Forces at Sea*, 2nd edition, 2017 (“2017 ICRC Commentary”), Neni 3, para. 512.

¹⁶² 2017 ICRC Commentary, para. 516-518.

¹⁶³ 1987 ICRC Commentary to Additional Protocol II regarding Article 2(2), para. 4491-4496.

cilin u krye krimi.¹⁶⁴ Në përcaktimin e ekzistencës së lidhjes me konfliktin duhet t'i kushtohet vëmendje: (i) statusit të kryesit dhe viktimës; (ii) nëse akti i shërben qëllimit përfundimtar të fushatës ushtarake; ose (iii) nëse akti u krye si pjesë e, apo në kontekstin e detyrave zyrtare të kryesit.¹⁶⁵

(iii) *Dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur*

91. Kryesi duhet të ketë dijëni për rrethanat faktike që përcaktojnë konfliktin e armatosur me karakter jondërkombëtar.¹⁶⁶ Nuk është e nevojshme që kryesi të ketë njohuri për klasifikimin e saktë ligjor të konfliktit të armatosur.¹⁶⁷

(b) *Kriteret konkrete në lidhje me krimet e luftës*

92. Të gjitha krimet duhet të kryhen kundër personave të mbrojtur. Pjesa e përgjithshme e nenit 14(1)(c) të Ligjit që përmend nenin e përbashkët 3(1) kërkon që viktima të mos ketë qenë pjesëmarrës aktiv në luftime në kohën e kryerjes së krimit.¹⁶⁸ Pjesëmarrja aktive në luftime nënkupton kryerjen e akteve në kuadër të

¹⁶⁴ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 58; [Stakić Appeal Judgment](#), para. 342; [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 70; ICTR/TPNR, *Setako v. Prosecutor*, ICTR-04-81-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 shtator 2011, para. 249; *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 26 maj 2003, para. 569-570.

¹⁶⁵ ICTY/TPNJ, [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 59; ICC/GJPN, [Bemba Trial Judgment](#), para. 143.

¹⁶⁶ ICTY/TPNJ, [Naletilić and Martinović Appeal Judgment](#), para. 118-121; [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgment](#)/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski, para. 295. Shih gjithashtu ICC/GJPN, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 698.

¹⁶⁷ ICTY/TPNJ, [Naletilić and Martinović Appeal Judgment](#), para. 119; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 311.

¹⁶⁸ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.9, Appeals Chamber, [Decision on Appeal from Denial of Judgment of Acquittal for Hostage-Taking](#) ("Karadžić Decision 11 December 2012"), 11 dhjetor 2012, para. 8, 21; IT-95-5/18-AR72.5, Appeals Chamber, [Decision on Appeal of Trial Chamber's Decision on Preliminary Motion to Dismiss Count 11 of the Indictment](#), 9 korrik 2009, para. 22-26; [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment](#)/Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski, para. 66; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Strugar Appeal Judgment"), 17 korrik 2008, para. 172, 178; *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Mucić et al. Appeal Judgment"), 20 shkurt 2001, para. 420, 424.

zhvillimit të luftimeve që për nga lloji ose qëllimi i tyre synojnë t'i shkaktojnë dëm faktik personelit ose pajisjeve të palës kundërshtare.¹⁶⁹ Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, apo çfarëdo shkakut tjetër, janë të mbrojtur sipas nenit të përbashkët 3.¹⁷⁰ Kryesi duhet të dijë ose duhet të kishte ditur për statusin e viktimave si persona që nuk marrin pjesë aktive në luftime.¹⁷¹

(i) *Ndalimi arbitrar*

93. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i ndalimit arbitrar si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi që sjell si pasojë heqjen e lirisë një personi i cili nuk merr pjesë në luftime, pa bazë ligjore dhe pa përmbushur garancitë procedurale bazë.

94. Heqja e lirisë është pa bazë ligjore kur nuk përlligjet prej një procesi penal dhe kur nuk ekzistojnë arsye për të besuar se heqja e lirisë është absolutisht e domosdoshme për shkak të sigurisë.¹⁷²

¹⁶⁹ ICTY/TPNJ, [Strugar Appeal Judgment](#), para. 178; ICC/GJPN, [Katanga Trial Judgment](#), para. 789-790. *Shin gjithashtu neni 13(3) i Protokollit Shtesë II.*

¹⁷⁰ Shpjeguesi i KNKK i vitit 2016 në lidhje me nenin e përbashkët 3, para. 539: "personat që janë jashtë luftimit për shkak se kanë shprehur qartë synimin e tyre për t'u dorëzuar, 'dorëzojnë armët' në kuptimin e nenit të përbashkët 3 dhe përfshihen në fushëveprimin mbrojtës të këtij neni. Më tej, neni i përbashkët 3 përmend këta faktorë të tjerë që mund ta nxjerrin një person jashtë luftimit: 'sëmundjet, plagët, ndalimi, ose çfarëdo shkakut tjetër'. Sëmundjet dhe plagët janë tipike në rastin e anëtarëve të forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar, po ashtu edhe ndalimi, që përdoret si nga palët shtetërore ashtu edhe nga ato joshetërore në konflikt. Shkaqe të tjera të daljes jashtë luftimit mund të jenë, për shembull, mbytyja e anijes, hedhja me parashutë nga një avion në avari, ose rënia në duart apo qenia nën kontrollin e një pale në konflikt – për shembull në një postbllok – edhe nëse situata ende nuk mund të konsiderohet se përbën ndalim. Shtesa e 'çfarëdo shkakut tjetër' tregon se nocioni 'jashtë luftimit' në nenin e përbashkët 3 nuk duhet interpretuar në një kuptim të ngushtë."

¹⁷¹ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3017; *Karadžić* Decision 11 December 2012, para. 22; [Bošković and Tarčulovski Appeal Judgment](#)/Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 66.

¹⁷² ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment, para. 320-322; *Kordić and Čerkez* Appeal Judgment, para. 72-73; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 465.

95. Garancitë procedurale bazë përfshijnë në veçanti: (i) detyrimin për ta informuar personin e arrestuar për arsyet e arrestimit; (ii) detyrimin për ta nxjerrë personin e arrestuar mbi bazë të një akuze penale menjëherë para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimin për t'i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë të bëjë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij.¹⁷³

96. Në kryerjen e vlerësimit nëse janë përmbushur garancitë procedurale bazë, nuk ka rëndësi nëse: (i) heqja e lirisë ishte fillimisht e përligjur¹⁷⁴ apo (ii) kryesi është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të drejtave procedurale të të ndaluarit.¹⁷⁵

97. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Sjellja dhe veprimet e kryesit duhet të jenë të qëllimshme. Gjithashtu, nuk duhet të ketë arsye që kryesi të besojë se ndalimi është absolutisht i domosdoshëm për shkak të shqetësimeve të palëve për sigurinë, ose kryesi të dijë se të ndaluarve nuk u janë akorduar garancitë e duhura procedurale, ose të tregohet qëllimisht shpërfillës nëse janë akorduar këto garanci apo jo.¹⁷⁶

(ii) *Trajtimi mizor*

98. *Elementet materiale (veprimi i fajshëm)*. Krimi i trajtimit mizor si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose që përbën cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.¹⁷⁷

¹⁷³ Rregulla 99, CIHL Study, Vol. I (Rregullat), f. 349-350. *Shih gjithashtu* Neni 6, Protokolli Shtesë II.

¹⁷⁴ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 322. *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 73; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#) para. 465.

¹⁷⁵ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 379.

¹⁷⁶ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 378.

¹⁷⁷ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 424. *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Haradinaj et al.*, IT-04-84-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Haradinaj et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Haradinaj dhe të tjerë*”), para. 93-94; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 595.

99. Shkalla e dëmtimit ose lëndimit duhet vlerësuar rast pas rasti, duke marrë parasysh faktorë si: (i) ashpërsia e veprimit të pretenduar; (ii) lloji i veprimit ose mosveprimit; (iii) konteksti në të cilin ka ndodhur veprimi; (iv) kohëzgjatja dhe/ose përsëritja e veprimit; (v) ndikimi fizik dhe mendor i veprimit mbi viktimën; dhe (vi) rrethanat personale të viktimës, ndër të cilat mosha, gjinia dhe gjendja shëndetësore.¹⁷⁸ Ndalimi ose izolimi i personave në kushte çnjerëzore mund të përbëjë trajtim mizor në disa rrethana,¹⁷⁹ por nuk përbën domosdoshmërisht trajtim mizor në vetvete.

100. Vuajtja e shkaktuar nga veprimi mbi viktimën nuk është e nevojshme të jetë afatgjatë, në qoftë se është reale dhe e rëndë.¹⁸⁰

101. *Elementi mendor (synimi kriminal)*. Kryesi duhet të ketë vepruar në mënyrë të qëllimshme ose me dijeninë se vuajtja apo lëndimi i rëndë mendor ose fizik, ose cenimi i rëndë i dinjitetit njerëzor, ishte pasojë e mundshme e veprimit ose mosveprimit.¹⁸¹

(iii) *Tortura*

102. Elementet materiale dhe mendore të torturës si krim lufte brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit janë të njëjta¹⁸² me ato të torturës si krim kundër njerëzimit

¹⁷⁸ ICTY/TPNJ, [Popović et al. Trial Judgment](#), poshtëshënimi 3249; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 584-585; *Prosecutor v. Mrkšić et al.*, IT-95-13/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Mrkšić et al. Trial Judgment”), 27 shtator 2007, para. 516, 525, 537; [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 131.

¹⁷⁹ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 554-558.

¹⁸⁰ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 131.

¹⁸¹ ICTY/TPNJ, [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 974; [Mrkšić et al. Trial Judgment](#), para. 516; *Limaj et al. Trial Judgment*/Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 231; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Strugar Trial Judgment”), 31 janar 2005, para. 261.

¹⁸²ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 178; [Brdanin Trial Judgment](#), para. 482; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 439; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 759.

brenda kuptimit të nenit 13(1)(f) të Ligjit,¹⁸³ me përjashtim të kritereve kontekstuale dhe statusit të mbrojtur të viktimës.

(iv) Vrasja e paligjshme

103. Elementet materiale dhe mendore të vrasjes së paligjshme si krim lufte brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit janë të njëjta¹⁸⁴ me ato të vrasjes së paligjshme si krim kundër njerëzimit brenda kuptimit të nenit 13(1)(a) të Ligjit,¹⁸⁵ me përjashtim të kritereve kontekstuale dhe statusit të mbrojtur të viktimës.

C. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

104. Prokuroria argumenton këto forma të përgjegjesisë penale: kryerje krimi në bazë të një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, ndihmë dhe inkurajim, dhe përgjegjësi si epror.¹⁸⁶ Elementet objektive dhe subjektive të këtyre formave të përgjegjesisë penale parashtrohen në vijim.

1. Ndërmarrje kriminale e përbashkët

105. Ndërmarrja kriminale e përbashkët (“NKP”) si formë e përgjegjesisë penale përfshin tri forma ose kategori (bazë, sistemore dhe e zgjeruar). Në formën bazë (“NKP I”) disa kryes veprojnë mbi bazën e një qëllimi të përbashkët; në formën sistemore (“NKP II”), që është një variant i formës së parë, krimet kryhen nga anëtarë të njësiteve ushtarake ose administrative brenda një sistemi të organizuar keqtrajtimi, si për shembull, në kampe përqendrimi ose ndalimi; në formën e

¹⁸³ *Shih më lart* para. 66-69 (Kritere të veçanta, Tortura).

¹⁸⁴ ICTY/TPNJ, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 323; [Naletilić and Martinović Trial Judgment](#), para. 248; [Blagojević and Jokić Trial Judgment](#), para. 556; ECCC/DHJGJK, [Duch Trial Judgment](#), para. 431; [Case 002/02 Trial Judgment](#), para. 757.

¹⁸⁵ *Shih më lart*, para. 70-71 (Kritere të veçanta, Vrasja e paligjshme).

¹⁸⁶ Aktakuza e Rishikuar, para. 32-55, 173.

zgjeruar (“NKP III”) një bashkëkryes mban përgjegjësi penale për akte që dalin jashtë kuadrit të planit të përbashkët, por që ishin pasojë e parashikueshme e realizimit të planit.¹⁸⁷

(a) Elementet objektive

106. Për të gjitha format e NKP-së kërkohet ekzistenca e këtyre elementeve objektive: (i) një shumësi personash që veprojnë në bazë të një qëllimi të përbashkët; (ii) një qëllim i përbashkët i cili përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi sikurse parashikohet në Ligj; dhe (iii) pjesëmarrja e kryesit në realizimin e projektit ose qëllimit të përbashkët.¹⁸⁸

107. *Shumësi personash.* NKP-ja ekziston kur një shumësi personash merr pjesë në realizimin e një objektivi kriminal të përbashkët.¹⁸⁹ Nuk është e nevojshme që personat pjesëmarrës në ndërmarrjen kriminale të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike ose administrative.¹⁹⁰ Megjithatë, ata duhet të identifikohen konkretisht, për shembull, me anë të emrit ose kategorive ose grupeve të personave.¹⁹¹

¹⁸⁷ ICTY/TPNJ, [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 82-83; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 98; [Tadić Appeal Judgment](#), para. 196, 202-203, 228. ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Ntakirutimana and Ntakirutimana*, ICTR-96-10-A and ICTR-96-17-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Ntakirutimana Appeal Judgment”), 13 dhjetor 2004, para. 464.

¹⁸⁸ ICTY/TPNJ, *Mladić Trial Judgment*, para. 3561; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 561, i referohet [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227; [Stakić Appeal Judgment](#), para. 64. *Shih gjithashtu* ICTR/TPNR, *Karempera and Ngirumpatse v. Prosecutor*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 29 shtator 2014, para. 110; [Ntakirutimana Appeal Judgment](#), para. 461-468; STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-O1/I, Appeals Chamber, [Interlocutory Decision on the Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging](#), (“Ayyash et al. Decision on Applicable Law”), 16 shkurt 2011, para. 236-249.

¹⁸⁹ ICTY/TPNJ, [Haradinaj et al. Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Haradinaj dhe të tjerë*, para. 138; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 307.

¹⁹⁰ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227.

¹⁹¹ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Krajišnik Appeal Judgment”), 17 mars 2009, para. 156-157; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 430.

108. *Qëllim i përbashkët që përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi.*

Nuk është e nevojshme që ky plan, projekt, ose qëllim të jetë organizuar ose formuluar më herët. Plani ose qëllimi i përbashkët mund të materializohet pa përgatitje paraprake dhe ekzistenca e tij të deduktohet nga fakti se një shumësi personash veprojnë së bashku për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët.¹⁹² Qëllimi i përbashkët nuk presupozon planifikim përgatitor ose marrëveshje të shprehur ndërmjet pjesëmarrësve në NKP, ose ndërmjet pjesëmarrësve në NKP dhe personave të tretë.¹⁹³ Për më tepër, NKP-ja mund të ekzistojë edhe nëse asnjë prej kryesve fizikë të krimeve nuk është anëtar i NKP-së, ose nëse vetëm disa prej tyre janë anëtarë të NKP-së, por përdoren nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së për të kryer krimet sipas qëllimit të përbashkët.¹⁹⁴

109. Në NKP III kryesi është përgjegjës për krime të kryera jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët, por që megjithatë janë pasojë objektivist e parashikueshme e atij qëllimi të përbashkët.¹⁹⁵

110. *Kontributi.* Kryesi duhet të ketë marrë pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët mbi të cilin bazohet NKP-ja duke ndihmuar ose duke kontribuar për zbatimin e planit ose qëllimit të përbashkët, por nuk është e nevojshme të ketë kryer ndonjë pjesë të veprimit të fajshëm të krimit për të cilin akuzohet.¹⁹⁶ Ligjërish nuk është e nevojshme që kontributi i kryesit në NKP të jetë i domosdoshëm ose i konsiderueshëm, por duhet të jetë më së paku një kontribut i

¹⁹² ICTY/TPNJ, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227; *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 21 korrik 2000, para. 119.

¹⁹³ ICTY/TPNJ, [Haradinaj et al. Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Haradinaj dhe të tjerë*, para. 138; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 418; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para.117-119.

¹⁹⁴ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 225-226, 235-236; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 410, 413.

¹⁹⁵ *Shih* referencën lidhur me standardin e “personit me maturi të arsyeshme” në STL, [Ayyash et al. Decision on Applicable Law](#), 16 shkurt 2011, para. 242.

¹⁹⁶ ICTY/TPNJ, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 215, 218, 695; [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227.

qenësishëm në krimet për të cilat ai ose ajo konstatohet se është përgjegjës.¹⁹⁷ Nuk është e nevojshme që kontributi në vetvete të jetë kriminal.¹⁹⁸

(b) Elementi subjektiv

111. Elementet subjektive ndryshojnë sipas kategorisë së NKP-së nën shqyrtim.

112. Sa i përket NKP I, kryesi duhet të ketë të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë për kryerjen e krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët, duke përfshirë edhe synimin konkret.¹⁹⁹

113. Në lidhje me NKP II, kërkohet njohuria personale për sistemin e keqtrajtimit si edhe synimi për të realizuar këtë sistem të përbashkët dhe të bashkërenduar të keqtrajtimit.²⁰⁰

114. Sa i përket NKP III, kryesi është përgjegjës për krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët në qoftë se në rrethanat e rastit: (i) kryesi kishte synimin të merrte pjesë dhe të kontribuonte në realizimin e qëllimit të përbashkët; (ii) për kryesin ishte e parashikueshme që krimi i zgjeruar mund të kryhej nga një ose më shumë anëtarë të grupit, ose nga persona të përdorur nga cilido anëtar i grupit, për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe (iii) kryesi me vullnet të lirë ndërmori rrezikun e mundësisë që të ndodhte krimi i zgjeruar kur mori pjesë në qëllimin e përbashkët.²⁰¹ Parashikueshmëria ndodh kur kryesi ishte i vetëdijshëm se krimi i kryer jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët ishte pasojë e mundshme e zbatimit

¹⁹⁷ ICTY/TPNJ, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 215, 662, 675, 695-696; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 430; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 97-98.

¹⁹⁸ ICTY/TPNJ, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 695.

¹⁹⁹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Dorđević*, IT-05-87/1-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“*Dorđević Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Gjorgjeviq*”), 27 janar 2014, para. 468.

²⁰⁰ ICTY/TPNJ, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 228; [Limaj et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë](#), para. 511; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 82.

²⁰¹ ICTY/TPNJ, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 228; [Šainović et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Shainović dhe të tjerë](#), 23 janar 2014, para. 1557; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 365, 411; [Stakić Appeal Judgment](#), para. 65; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 83.

të atij qëllimi të përbashkët.²⁰² Kryesi ndërmer rrezik me vullnet të lirë kur, duke qenë i vetëdijshëm se një krim i tillë është pasojë e mundshme e zbatimit të ndërmarrjes, vendos të marrë pjesë në atë ndërmarrje.²⁰³

115. Në përcaktimin nëse krimi ishte i parashikueshëm për kryesin, janë shqyrtuar, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: (i) njohuria për mënyrën e zbatimit të NKP-së në terren;²⁰⁴ (ii) dijenia për të shkuarën kriminale dhe tendencën e anëtarëve të ndërmarrjes për kryerje të krimeve;²⁰⁵ (iii) deklaratat e kryesit;²⁰⁶ (iv) koha dhe vendi i kryerjes së krimeve jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët;²⁰⁷ (v) njohuria për motivet personale për hakmarrje të anëtarëve të ndërmarrjes ose personave të përdorur prej tyre;²⁰⁸ (vi) dijenia për urrejtjen etnike ndërmjet palëve në konflikt;²⁰⁹ dhe (vii) njohuria për veprimtaritë e vartësve-kryes në keqtrajtimin e të burgosurve.²¹⁰

2. Ndhimja dhe inkurajimi

(a) Elementet objektive

116. Ndhimja dhe inkurajimi përmes veprimit ose mosveprimit,²¹¹ kërkon që kryesi të ndihmojë, inkurajojë, ose të japë mbështetje morale për kryerjen e një

²⁰² Mundësia e kryerjes së krimit të zgjeruar duhet të jetë mjaftueshmërisht e konsiderueshme që të jetë logjikisht e parashikueshme mbi bazën e informacionit që dispononte kryesi në atë kohë. *Shih*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Stanišić and Župljanin Judgment*”), 30 qershor 2016, para. 627.

²⁰³ ICTY/TPNJ, [Brdanin Appeal Judgment](#), para. 411.

²⁰⁴ ICTY/TPNJ, [Stanišić and Župljanin Judgment](#), para. 627, 1002.

²⁰⁵ ICTY/TPNJ, [Stanišić and Župljanin Judgment](#), para. 628, 647, 1002.

²⁰⁶ ICTY/TPNJ, [Šainović et al. Appeal Judgment](#)/Aktgjykimi i Apelit *Shainović dhe të tjerë*, 23 janar 2014, para. 1090.

²⁰⁷ ICTY/TPNJ, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 1434.

²⁰⁸ ICTY/TPNJ, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 1434.

²⁰⁹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Tolimir Appeal Judgment*”), 8 prill 2015, para. 520; [Stanišić and Župljanin Judgment](#), para. 1002.

²¹⁰ ICTY/TPNJ, [Tolimir Appeal Judgment](#), para. 539.

²¹¹ ICTY/TPNJ, [Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment](#), para. 49, 134, 154; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 47.

krimi dhe kjo mbështetje ka ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimit.²¹² Ndihma dhe inkurajimi mund të ndodhë para, gjatë, ose pas kryerjes së krimit dhe në një vend të ndryshëm nga ai i krimit.²¹³ Është e panevojshme të vërtetohet se krimi nuk do të ishte kryer pa kontributin e ndihmuesit e inkurajuesit²¹⁴ apo se ekzistonte një plan apo marrëveshje ndërmjet ndihmuesit e inkurajuesit dhe kryesit.²¹⁵ Po kështu, nuk është kusht të provohet se veprimet e ndihmuesit e inkurajuesit kishin objektivin konkret për të ndihmuar, inkurajuar, ose për të dhënë mbështetje morale për kryerjen e krimeve.²¹⁶

(b) Elementi subjektiv

117. Ndhmuesi e inkurajuesi duhet të ketë njohuri se veprimet ose mosveprimet e veta ndihmojnë në kryerjen e krimit nga kryesi.²¹⁷ Në veçanti, ndihmuesi e inkurajuesi duhet të ketë dijeni për elementët thelbësorë të krimit që u krye,²¹⁸ ndër të cilët, gjendja mendore e kryesit dhe çfarëdo synimi konkret që ka lidhje me të,²¹⁹ por nuk është e nevojshme që ai ose ajo të ketë atë synim konkret.²²⁰

²¹² ICTY/TPNJ, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 229; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 102; *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Aleksovski Appeal Judgment*”), 24 mars 2000, para. 162, 164; ICTR/TPNR, *Kalimanzira v. Prosecutor*, ICTR-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Kalimanzira Appeal Judgment*”), 20 tetor 2010, para. 74; [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 482; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Taylor Appeal Judgment*”), 26 shtator 2013, para. 475.

²¹³ ICTY/TPNJ, [Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment](#), para. 81; [Simić Appeal Judgment](#), para. 85; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 48; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 352; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 482.

²¹⁴ ICTY/TPNJ, [Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment](#), para. 81; [Simić Appeal Judgment](#), para. 85; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 48.

²¹⁵ ICTY/TPNJ, [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 263; [Tadić Appeal Judgment](#), para. 229.

²¹⁶ ICTY/TPNJ, [Šainović et al. Appeal Judgment](#) /Aktgjykimi i Apelit Shainoviq dhe të tjerë, para. 1649-1651.

²¹⁷ ICTY/TPNJ, [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 102; ICTR/TPNR, [Kalimanzira Appeal Judgment](#), para. 86; SCSL/GJSSL, [Taylor Appeal Judgment](#), para. 437.

²¹⁸ ICTY/TPNJ, [Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment](#), para. 49, 159; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 484.

²¹⁹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*, IT-02-60-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 9 maj 2007, para. 127; ; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 142; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 52.

²²⁰ ICTY/TPNJ, [Simić Appeal Judgment](#), para. 86; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 52; [Aleksovski Appeal Judgment](#), para. 162.

3. Përgjegjësia si epror

(a) Elementet objektive

118. Që eprori të mbajë përgjegjësi penale, duhet të vërtetohen elementet objektive në vijim: (i) ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës dhe (ii) mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme nga eprori për parandalimin e krimit ose të krimeve të vartësit ose vartësve të tij, ose mosndëshkimi prej tij i kryesve për ato krime.²²¹ Neni 16 i Ligjit nuk parasheh kushtin e ekzistencës së shkakësisë ndërmjet mosparandalimit të krimit prej eprorit dhe kryerjes së krimit.²²²

119. *Ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës*. Kryesi duhet të jetë epror me pushtet *de jure* ose *de facto*²²³ mbi vartësit të cilët kanë kryer një ose më shumë krime sipas neneve 13-14 të Ligjit. Kjo marrëdhënie mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë,²²⁴ brenda një hierarkie që është zyrtare ose jozyrtare,²²⁵ dhe civile ose ushtarake.²²⁶ Për të mbajtur përgjegjësi, eprori duhet të ketë aftësinë materiale që të parandalojë ose ndëshkojë vartësin në kohën e kryerjes së krimit (“kontroll efektiv”).²²⁷ Ndër faktorët që duhen marrë parasysh në vlerësimin e kontrollit

²²¹ ICTY/TPNJ, [Aleksovski Appeal Judgment](#), para. 72; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), 28 nëntor 2007, para. 484.

²²² ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Hadžihasanović and Kubura*, IT-01-47-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgment*”), 22 prill 2008, para. 38-40; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 73-77.

²²³ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 192-193, 195; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#) (“*Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*”), 1 qershor 2001, para. 294.

²²⁴ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Halilović Appeal Judgment*”), 16 tetor 2007, para. 59; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 252, 303.

²²⁵ ICTY/TPNJ, [Halilović Appeal Judgment](#), para. 59; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 197, 303; ICTR/TPNR, [Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment](#), para. 294.

²²⁶ ICTY/TPNJ, [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 195-196; ICTR/TPNR, *Kajelijeli v. Prosecutor*, ICTR-98-44A-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 23 maj 2005, para. 85.

²²⁷ ICTY/TPNJ, [Aleksovski Appeal Judgment](#), para. 76; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 59; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 191-192, 196-198, 256, 266, 303; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Ntawukulilyayo*, ICTR-05-82-T, Trial Chamber, [Judgement and Sentence](#) (“*Ntawukulilyayo Trial Judgment*”), 3 gusht 2010,

efektiv përfshihen, ndër të tjera: (i) pozita e kryesit; (ii) aftësia e kryesit për të lëshuar urdhra dhe nëse këta urdhra u zbatuan faktikisht; (iii) autoriteti për të marrë masa disiplinore; dhe (iv) kompetenca për të ngritur në përgjegjësi ose për të shkarkuar nga detyra anëtarë të personelit.²²⁸

120. *Mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme*. Eprori ka dy detyra të dallueshme: detyrën për parandalimin e krimeve (të ardhshme) dhe detyrën për ndëshkimin e vartësit për krime (të shkuara).²²⁹ Detyra e eprorit për parandalim buron që prej momentit kur eprori di ose ka arsye të dijë se një vartës nën kontrollin e tij është në prag të kryerjes së një krimi, ndërsa detyra e ndëshkimit buron pasi vartësi e ka kryer krimin.²³⁰ Eprori mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e çdonjëres prej këtyre detyrave. Rrjedhimisht, mosparandalimi i krimit nuk mund të ndreqet duke e ndëshkuar më pas vartësin për krimin.²³¹

121. Masa “të nevojshme” janë masat e përshtatshme që eprori të përmbushë detyrën e vet nëpërmjet përpjekjeve të mirëfillta për parandalim ose ndëshkim, ndërsa masa “të arsyeshme” janë ato që përfshihen logjikisht në kompetencat materiale të eprorit.²³² Se çfarë është “e nevojshme dhe e arsyeshme” varet nga

para. 420; *Prosecutor v. Karera*, ICTR-01-74-T, Trial Chamber, [Judgement and Sentence](#), 7 dhjetor 2007, para. 564; [Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment](#), para. 294.

²²⁸ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 shkurt 2013, para. 97; [Strugar Appeal Judgment](#), para. 254; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 66; [Orić Trial Judgment](#), para. 312; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 190, 206.

²²⁹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Đorđević*, IT-05-87/1-T, Trial Chamber, [Public Judgement with Confidential Annex](#)/Aktgjykimi Publik me Shtojcë Konfidenciale (“*Đorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*”), 23 shkurt 2011, para. 1888; *Prosecutor v. Delić*, IT-04-83-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“*Delić Trial Judgment*”), 15 shtator 2008, para. 69; [Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgment](#), para. 259; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 83; [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 333-334.

²³⁰ ICTY/TPNJ, [Delić Trial Judgment](#), para. 69, 72; [Strugar Trial Judgment](#) para. 416; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 445-446.

²³¹ ICTY/TPNJ, [Delić Trial Judgment](#), para. 69; [Strugar Trial Judgment](#), para. 373; [Blaškić Trial Judgment](#), para. 336.

²³² ICTY/TPNJ, [Đorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq](#), para. 1887; *Prosecutor v. Orić*, IT-03-68-A, Appeals Chamber, [Judgement](#)/Dhoma e Apelit, Aktgjykim, 3 korrik 2008, para. 177; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 63.

provat dhe duhet të analizohet konkretisht.²³³ Në detyrën e parandalimit mund të përfshihen masa si: (i) sigurimi i raporteve që veprimet ushtarake janë kryer në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;²³⁴ (ii) lëshimi i urdhrave që synojnë përputhshmërinë e praktikave përkatëse me rregullat e konfliktit të armatosur;²³⁵ (iii) marrja e masave disiplinore për të parandaluar kryerjen e mizorive; ose (iv) insistimi para një autoriteti epror për marrjen e masave të menjëhershme.²³⁶ Në detyrën e ndëshkimit mund të përfshihen, më së paku: (i) detyrimi për të hetuar krime të mundshme ose për të kërkuar që çështja të hetohet, dhe, (ii) në qoftë se eprori nuk ka kompetenca për të ndëshkuar, të bëjë raportimin e tyre tek autoritetet kompetente.²³⁷ Shkalla e kontrollit efektiv mund të përdoret për të përcaktuar se cilat masa janë të nevojshme dhe të arsyeshme brenda kompetencës së eprorit.²³⁸

(b) Elementi subjektiv

122. Sipas nenit 16(1)(c) të Ligjit, eprorët duhet të kenë ditur faktikisht²³⁹ ose duhet të kenë pasur arsye të dinin se vartësit ishin në prag të kryerjes së një krimi apo e kishin kryer atë. Për të përcaktuar nëse eprorët “kishin arsye të dinin”, duhet

²³³ ICTY/TPNJ, [Dorđević Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Gjorgjeviq* para. 1887; [Delić Trial Judgment](#), para. 76; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 72, 417.

²³⁴ ICTY/TPNJ, [Delić Trial Judgment](#), para. 76; [Strugar Trial Judgment](#), para. 374.

²³⁵ ICTY/TPNJ, [Delić Trial Judgment](#), para. 76; [Strugar Trial Judgment](#), para. 374.

²³⁶ ICTY/TPNJ, [Strugar Trial Judgment](#), para. 374.

²³⁷ ICTY/TPNJ, [Dorđević Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1890; [Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgment](#), para. 154; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 182; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 83.

²³⁸ ICTY/TPNJ, [Dorđević Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1887; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 63; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 72.

²³⁹ Ndër faktorët për nxjerrjen e konstatimit për dijeni faktike të eprorit përfshihen, për shembull: numri i veprimeve të paligjshme, çka përfshihet në to, nëse janë gjerësisht të përhapura, koha e ndodhjes së tyre, lloji dhe numri i vartësve të përfshirë, mjetet e disponueshme të komunikimit, fushëveprimi dhe lloji i pozitës së eprorit dhe vendndodhja e tij në atë kohë, dhe vendndodhja gjeografike e krimeve, shih ICTY/TPNJ, [Dorđević Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1885; [Orić Trial Judgment](#), para. 319; [Blaškić Trial Judgment](#), para. 307; [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 386; ICTR/TPNR, [Ntawukulilyayo Trial Judgment](#), para. 420-421.

të vërtetohet se ata duhet të kenë disponuar informacion mjaftueshmërisht alarmues që i vinte në dijeni për krime të kryera ose në prag të kryerjes prej vartësve të tyre dhe që përlligjite hetim të mëtejshëm.²⁴⁰ Nuk është e nevojshme që eprori të ketë të njëjtin synim, në veçanti të njëjtin synim konkret, si vartësi.²⁴¹ Njohuria kërkon vlerësim të situatës konkrete të eprorit gjatë kohës në fjalë.²⁴²

VI. AKUZAT

123. Përpara shqyrtimit të materialit mbështetës në lidhje me secilën akuzë dhe nxjerrjes së konstatimit nëse është vërtetuar një dyshim i bazuar mirë kundër të dyshuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja i ka përmbushur kriteret e rregullës 86(3) të Rregullores përmes dorëzimit të: (i) një aktakuze të rishikuar; (ii) materialit provues që mbështet faktet mbi të cilat janë ngritur akuzat; dhe (iii) një përmbledhjeje të detajuar dhe materialit plotësues të përditësuar, që tregojnë lidhjen e secilës provë në materialin provues me secilën akuzë.

A. KRITERET KONTEKSTUALE

1. Kriteret kontekstuale të krimeve kundër njerëzimit

124. Në Aktakuzën e Rishikuar, ZPS-ja pretendon se krimet e paraqitura në Aktakuzë ndodhën gjatë periudhës së Aktakuzës²⁴³ dhe ishin pjesë e një sulmi të përhapur gjerësisht ose sistematik kundër popullatës civile të kundërshtarëve në

²⁴⁰ ICTY/TPNJ, [Dorđević Trial Judgment](#)/Aktgjykimi *Gjorgjeviq*, para. 1886; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 59, 155; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 238-239, 241; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 791; *Prosecutor v. Bagilishema*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#), 3 korrik 2002, para. 28, 42.

²⁴¹ ICTY/TPNJ, [Brđanin Trial Judgment](#) para. 720-721; [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 155; ICTR/TPNR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 865.

²⁴² ICTY/TPNJ, [Krnojelac Appeal Judgment](#), para. 156; [Mucić et al. Appeal Judgment](#), para. 239.

²⁴³ Aktakuza e Rishikuar, para. 16-17.

Kosovë dhe në zona të Shqipërisë Veriore.²⁴⁴ Sipas ZPS-së, ndër kundërshtarët përfshiheshin ata që ishin ose konsideroheshin se: (i) kishin bashkëpunuar ose kishin lidhje me forca, zyrtarë, ose institucione shtetërore të RFJ-së; ose (ii) ndryshe nuk përkrahnin qëllimet ose metodat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) dhe më vonë të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (“QPK”), ndër të cilët persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (“LDK”) dhe me serbë, romë, dhe persona të kombësive të tjera.²⁴⁵

125. Në lidhje me ekzistencën e sulmit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton që materiali mbështetës tregon se, së paku midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999, anëtarë të UÇK-së kryen akte të shumta dhune dhe keqtrajtimi kundër qindra civilëve në të gjithë Kosovën dhe Shqipërinë Veriore.²⁴⁶ Anëtarët e UÇK-së u përfshinë në akte të dhunshme, si arrestime, ndalime, keqtrajtime, torturë dhe/ose vrasje.²⁴⁷ Persona civilë u arrestuan në postblloqe, në rrugë, në shtëpitë e tyre ose vendet e punës dhe shumë prej tyre u keqtrajtuuan në kohën e arrestimit. Në vijim, pjesa më e madhe e tyre u transferuan në një ose më shumë qendra ndalimi, ku u frikësuan, keqtrajtuuan, morën në pyetje, torturuan dhe/ose vranë.²⁴⁸ Kjo praktikë sjelljeje sugjeron një fushatë dhune dhe keqtrajtimi që përbënte “sulum”.

126. Në lidhje me caqet e sulmit, materiali mbështetës tregon se aktet e dhunës dhe keqtrajtimit të përmendura më lart u kryen kundër civilëve që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së. Që në vitin 1994 ishin bërë deklarata

²⁴⁴ Aktakuza e Rishikuar, para. 16-17.

²⁴⁵ Aktakuza e Rishikuar, para. 32.

²⁴⁶ IT-03-66 P212.4, f. 4, 23-24 (00676473, 00676492-00676493); IT-04-84 P00931, para. 20, 22, 32, 37, 51, 62 (U0171203, U0171210, U0171213, U0171215, U0171221, U0171227); [REDAKTUAR]; IT-03-66 P150, f. 6-7 (K0350562-K0350563); [REDAKTUAR]; IT-04-84 P00006, f. 11, 17-19, 28-32 (00649677, 00649683-00649685, K0078704-K0078708). *Shih gjithashtu më poshtë*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 362-417 (Pikat 8-9).

²⁴⁷ IT-03-66 P212.4, f. 4, 23-24 (00676473, 00676492-00676493); IT-04-84 P00931, para. 51, 62 (U0171221, U0171227); [REDAKTUAR]; IT-04-84 P00006, f. 11 (00649677).

²⁴⁸ *Shih më poshtë*, para. 139-444 (Pikat 2-3, 4-5, 6-7, 8-9, 10 dhe 1).

publike që bënin thirrje për dhunë kundër kundërshtarëve, shpesh të cilësuar si tradhtarë, bashkëpunëtorë ose pacifistë,²⁴⁹ dhe këto u intensifikuan pas fillimit të konfliktit të armatosur ²⁵⁰ në mars 1998. ²⁵¹ Ndër ata që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së përfshiheshin: (i) popullatat serbe, rome dhe ashkalie; (ii) katolikët; (iii) civilët që pretendoheshin se bashkëpunonin me autoritetet serbe ose se kishin kontakte me serbë; (iv) shqiptarët që kishin lidhje me ose përkrahnin LDK-në, ose parti të tjera që konsideroheshin kundër UÇK-së; (v) shqiptarët që nuk ishin anëtarësuar në UÇK ose nuk e përkrahnin atë; dhe (vi) personat të punësuar në atë kohë, ose të punësuar më parë që konsideroheshin kundër UÇK-së (bashkërisht, “kundërshtarët”).²⁵² Materiali mbështetës tregon se, ndonëse një numër i vogël i këtyre personave ishin të punësuar ose kishin lidhje me ushtrinë ose policinë serbe/jugosllave, ata nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e arrestimit të tyre dhe u vunë në shënjestër për shkak se konsideroheshin kundërshtarë.²⁵³ Gjithashtu, në deklaratat publike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, si dhe në deklaratat e vetë të dyshuarve, thuhej shprehimisht se aktet e dhunës dhe keqtrajtimit ishin një paralajmërim për të gjithë kundërshtarët e tjerë,²⁵⁴ duke vënë kështu në shënjestër dhe duke ushtruar tryzni edhe mbi familjet dhe komunitetet e kundërshtarëve. Për më tepër, anëtarët e UÇK-së vazhdimisht refuzuan të jepnin informacion të saktë për ndalimin dhe vendndodhjen e kundërshtarëve, duke shkaktuar pasoja të mëtejshme ndaj familjeve dhe komuniteteve të tyre.²⁵⁵ Numri i madh dhe kategoritë e ndryshme të njerëzve të

²⁴⁹ [REDAKTUAR].

²⁵⁰ *Shih më poshtë*, para. 131-137 (Kriteret kontekstuale të krimeve të luftës).

²⁵¹ [REDAKTUAR].

²⁵² *Shih më poshtë* para. 443 (Pika 1). *Shih gjithashtu* IT-04-84 P00931, para. 32, 62 (U0171213, U0171227); [REDAKTUAR]; IT-04-84 P00006, f. 11 (00649677); IT-03-66 P150, f. 6-7 (K0350562-K0350563); [REDAKTUAR].

²⁵³ Jabllanicë: *më poshtë*, para. 144. Llapushnik: *më poshtë*, para. 147. Kleçkë: *më poshtë*, poshtëshënimi 462. [REDAKTUAR], Prizren: *më poshtë*, para. 206. Ish-shkolla me konvikt/ish-konvikti, Gjilan: *më poshtë*, para. 218. Ish-stacioni i policisë, Suharekë: *më poshtë*, para. 221.

²⁵⁴ *Shih më lart* poshtëshënimet 249, 251. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

²⁵⁵ *Shih më poshtë*, para. 419-436 (Pika 10).

vënë në shënjestër tregojnë se sulmi faktikisht drejtohej kundër një segmenti të konsiderueshëm të popullatës civile të Kosovës.

127. Për sa i përket karakterit gjerësisht të përhapur të sulmit, materiali mbështetës tregon se aktet e dhunës dhe keqtrajtimit u kryen në shkallë të gjerë në më shumë se 30 vendndodhje, disa prej të cilave përfshinin një numër vendndodhjesh (ndalimi)²⁵⁶ në të paktën 16 komuna të Kosovës dhe dy rrethe të Shqipërisë.²⁵⁷ Materiali mbështetës tregon për një numër të madh rrëmbimesh, ndalimesh, ekzekutimesh dhe zhdukjesh midis fillimit të vitit 1998 dhe verës së vitit 1999, të kryera nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra serbëve, romëve, dhe shqiptarëve që konsideroheshin si mospërkrahës të UÇK-së.²⁵⁸ Për më tepër, në vitet 1998-1999, në Kosovë dihej gjerësisht se kundërshtarët keqtrajtoheshin dhe/ose vriteshin.²⁵⁹ Numri i madh i viktimave dhe përhapja gjeografike e vendndodhjeve (të ndalimit) ku u kryen aktet e dhunës, keqtrajtimit dhe vrasjes, demonstrojnë se ekzistonte sulm i përhapur gjerësisht kundër popullatës civile.

128. Në lidhje me karakterin sistematik të sulmit, materiali mbështetës tregon se aktet e lartpërmendura të dhunës dhe keqtrajtimit u kryen në mënyrë të organizuar dhe ndoqën të njëjtën praktikë. Deklaratat publike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, rregulloret dhe botime të tjera, si edhe deklaratat e vetë të dyshuarve, bënë thirrje në mënyrë të përsëritur dhe publikisht për dhunë ndaj kundërshtarëve ose e miratonin atë, duke treguar në këtë mënyrë për një organizim të dhunës nga kreu.²⁶⁰ Këtë e konfirmojnë më tej materiale mbështetëse që tregojnë se anëtarë të lartë të UÇK-së, ndër të cilët edhe të dyshuarit, anëtarë të

²⁵⁶ *Shih më poshtë*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 362-417 (Pikat 8-9);

²⁵⁷ *Shih më poshtë*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 362-417 (Pikat 8-9); para. 419-436 (Pika 10), para. 438-444 (Pika 1).

²⁵⁸ IT-03-66 P212.4, f. 23-25 (00676492-00676494); IT-03-66 P150, f. 6-7 (K035-562-K035-563); [REDAKTUAR]; IT-04-84 P00006, f. 17-19, 28-32 (0064-9683-0064-9685, K007-8704-K0007-8708); [REDAKTUAR].

²⁵⁹ [REDAKTUAR].

²⁶⁰ *Shih më lart*, poshtëshënimet 249, 251.

tjerë të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantë, morën pjesë në aktet e dhunës dhe keqtrajtimit.²⁶¹ Udhëheqja e UÇK-së krijoi struktura policore dhe të zbulimit të cilat kishin për detyrë të identifikonin dhe hetonin kundërshtarët.²⁶² Disa nga kundërshtarët u përmendën me emër në deklaratat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,²⁶³ kurse shumë të tjerë u përfshinë në listat e bashkëpunëtorëve të pretenduar.²⁶⁴ Kjo tregon për një praktikë të organizuar dhe jo të rastësishme të vënies në shënjestër të kundërshtarëve. Gjithashtu, udhëheqja e UÇK-së i konsideronte [REDAKTUAR], që meritonin masa ndëshkimore, përfshirë vrasjen.²⁶⁵ Shumë nga kundërshtarët u mbajtën të ndaluar në shtabe, baza apo kazerma të UÇK-së anembanë Kosovës dhe në Shqipërinë Veriore,²⁶⁶ si edhe u transferuan nga një qendër ndalimi në tjetrën e u mbajtën në shumë prej tyre.²⁶⁷ Kjo tregon se aktet e dhunës dhe keqtrajtimit kishin një shkallë të konsiderueshme

²⁶¹ *Shih më poshtë*, para. 452-454 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I). *Shih gjithashtu p.sh.* Likoc: *më poshtë*, para. 235. Llapushnik: *më poshtë*, para. 148. Drenoc: *më poshtë*, para. 150, 375, 425. Malishevë: *më poshtë*, para. 153, 251, 384, 430. Bare dhe Bajgorë: *më poshtë*, para. 161. Zllash: *më poshtë*, para. 267. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 169, 271, 359. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 275. Kleçkë: *më poshtë*, para. 175, 279, 359, 397, 401. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 403, 434. Cahan: *më poshtë*, para. 183, 287. Kukës: *më poshtë*, para. 291, 359. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 299. [REDAKTUAR], Prizren: *më poshtë*, para. 207, 319. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 216. Novobërdë: *më poshtë*, para. 346. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 413. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 415.

²⁶² Rreth qershorit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së themeloi drejtorinë e zbulimit G2, e cila kishte për detyrë, ndër të tjera, [REDAKTUAR] dhe të zbulonte [REDAKTUAR] brenda dhe jashtë ushtrisë. *Shih më poshtë*, para. 455-456 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I). [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu* para. 259 (Pikat 4-5) [REDAKTUAR].

²⁶³ [REDAKTUAR].

²⁶⁴ [REDAKTUAR]. Llapushnik: [REDAKTUAR]. Drenoc: [REDAKTUAR]. Malishevë: [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR]. Bare dhe Bajgorë: [REDAKTUAR]. Llapashticë dhe vende të lidhura me të: [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR], Prizren: [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR].

²⁶⁵ [REDAKTUAR].

²⁶⁶ *Shih p.sh.* Likoc: *më poshtë*, para. 139. Jabllanicë: *më poshtë*, para. 142. Drenoc: *më poshtë*, para. 149. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 156. Llapashticë: *më poshtë*, para. 162. Kleçkë: *më poshtë*, para. 175. Cahan: *më poshtë*, para. 181. Kukës: *më poshtë*, para. 184. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 187. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 190. [REDAKTUAR], Prizren: *më poshtë*, para. 205. [REDAKTUAR], Prizren: *më poshtë*, para. 208. Ish-shkolla me konvikt/ish-konvikti, Gjilan: *më poshtë*, para. 217. Novobërdë: *më poshtë*, para. 223. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 227.

²⁶⁷ *Shih p.sh.* Likoc: *më poshtë*, para. 235. Malishevë: *më poshtë*, para. 251, 381, 382, 384. Llapashticë: *më poshtë*, para. 263. Potok: *më poshtë*, para. 391. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 271. Kleçkë: *më poshtë*, para. 279. [REDAKTUAR]: *më poshtë*, para. 178, 283, 403.

473. Materiali mbështetës gjithashtu tregon se të dyshuarit kishin synimin e përbashkët të kryerjes së krimeve të përfshira në Pikat 1-10 që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së. Rrjedhimisht, synimi i tyre duket nga: (i) deklaratat e vetë të dyshuarve;²⁰⁶⁴ (ii) deklaratat publike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe/ose udhëheqjes së QPK-së, si dhe rregulloret, strukturat, udhëzuesit dhe urdhrat e hartuara, lëshuara apo miratuara nga të dyshuarit;²⁰⁶⁵ dhe (iii) nga sjellja individuale e tyre përshkruar më lart.²⁰⁶⁶

(c) Përfundim

474. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se të dyshuarit kryen, si anëtarë të NKP-së, krimet e përfshira në Pikat 1-10, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

2. Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët III

475. Në Aktakuzën e Rishikuar, ZPS-ja në alternativë pretendon se, në qoftë se disa nga krimet e përfshira në Pikat 1-10 nuk ishin pjesë e NKP-së së lartpërmendur, të dyshuarit janë gjithsesi përgjegjës në bazë të nenit 16(1)(a) të

²⁰⁶² IT-04-84bis T675-T771, f. 681-685; [REDAKTUAR].

²⁰⁶³ [REDAKTUAR].

²⁰⁶⁴ [REDAKTUAR].

²⁰⁶⁵ *Shih më lart*, para. 454 dhe poshtëshënimet 1953, 1954, 1955, 1956 dhe 1957.

²⁰⁶⁶ *Shih më lart*, para. 455-472.

Ligjit për kryerjen e tyre, duke qenë se ishte e parashikueshme për ta që krime të tilla ishin pasojë e mundshme e zbatimit të NKP-së dhe ata e morën përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë.²⁰⁶⁷

476. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shqyrton këtë formë të përgjegjësisë penale si alternativë, në rast se disa nga krimet e përfshira në Pikat 1-10 ishin jashtë qëllimit të përbashkët të NKP-së së lartpërmendur. Rrjedhimisht, lidhur me elementet objektive të kësaj forme përgjegjësie penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve si më lart: se ekzistonte një NKP për marrjen dhe ushtrimin e kontrollit mbi të gjithë Kosovën, ndër të tjera, përmes frikësimit, keqtrajtimit, kryerjes së dhunës dhe eliminimit të paligjshëm të kundërshtarëve; dhe se të dyshuarit ishin pjesë e saj.²⁰⁶⁸ Për më tepër, mënyra e organizuar e zbatimit të NKP-së, përkatësisht praktikat e frikësimit, ndalimit, keqtrajtimit dhe vrasjes së kundërshtarëve,²⁰⁶⁹ i bënë krimet e përmendura në Pikat 1-10 pasojë objektive të parashikueshme të zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së.

477. Lidhur me elementin subjektiv të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më lart konstatoi se të dyshuarit kishin synim të merrnin pjesë dhe të kontribuonin në realizimin e qëllimit të përbashkët.²⁰⁷⁰ Gjithashtu, materiali mbështetës tregon se ishte e parashikueshme për të dyshuarit që krimet e përfshira në Pikat 1-10 mund të kryheshin gjatë zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së. Në veçanti, të dyshuarit: (i) në vazhdimësi dhe publikisht bënë thirrje për dhunë ose mbështetën dhunën ndaj kundërshtarëve përmes deklaratave të tyre personale dhe deklaratave publike të udhëheqjes së UÇK-së/QPK-së;²⁰⁷¹ dhe (ii) krijuan, mbajtën ose kishin dijeni për struktura të zbulimit dhe policisë që kishin për detyrë identifikimin, hetimin dhe neutralizimin e

²⁰⁶⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 34-35.

²⁰⁶⁸ *Shih më lart*, para. 452-474 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁶⁹ *Shih më lart*, para. 139-444 (Pikat 1-10) dhe para. 455-472 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁷⁰ *Shih më lart*, para. 473 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁷¹ *Shih më lart*, poshtëshënimet 1953, 1954, 1955, 1956 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

kundërshtarëve.²⁰⁷² Gjithashtu, fakti që të dyshuarit morën me vullnet të lirë rrezikun se mund të kryheshin krime jashtë qëllimit të përbashkët, mund të deduktohet edhe nga: (i) dijenia e tyre për dislokimin e rekrutëve të UÇK-së pa stërvitje të mjaftueshme ushtarake dhe me njohuri të pakta ose pa kurrfarë njohurish për detyrimet e së drejtës humanitare ndërkombëtare;²⁰⁷³ (ii) fakti që ishin të vetëdijshëm se udhëheqja e UÇK-së nuk kishte dhënë kurrfarë përkufizimi të qartë për [REDAKTUAR] dhe nuk kishte një procedurë për përcaktimin e një roli të tillë, çka u hapi rrugën abuzimeve;²⁰⁷⁴ dhe (iii) fakti që megjithëse dihej prej tyre dhe prej të gjithëve për krimet kundër kundërshtarëve në Kosovë,²⁰⁷⁵ ata mbështetën në vazhdimësi dhunën ndaj kundërshtarëve dhe personalisht morën pjesë ose kontribuan në kryerjen e krimeve të përfshira në Pikat 1-10.²⁰⁷⁶

478. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se si alternativë e përgjegjësisë së pretenduar të të dyshuarve në bazë të NKP I, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi kryen krimet e përfshira në Pikat 1-10, duke qenë se ishte e parashikueshme për ta që krime të tilla ishin pasojë e mundshme e zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe ata e morën përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

3. Ndihma dhe inkurajimi

479. Gjithashtu dhe si alternativë ndaj përgjegjësisë së pretenduar për kryerje krimesh, në Aktakuzën e Rishikuar ZPS-ja pretendon se të dyshuarit janë

²⁰⁷² *Shih më lart*, para. 455-472 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I); [REDAKTUAR].

²⁰⁷³ [REDAKTUAR].

²⁰⁷⁴ *Shih më lart*, para. 456 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁷⁵ [REDAKTUAR].

²⁰⁷⁶ *Shih më lart*, para. 455-472 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

penalisht përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të përfshira në Pikat 1-10 sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.²⁰⁷⁷

480. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme përgjegjësie penale, materiali mbështetës tregon se veprimet dhe mosveprimet e të dyshuarve përbënin ndihmë praktike, inkurajim ose mbështetje morale për kryerjen e krimeve të lartpërmendura. Në veçanti, të dyshuarit: (i) morën pjesë në formulimin dhe miratimin e deklaratave publike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, si edhe të rregulloreve, strukturave, udhëzimeve dhe urdhrave që synonin kundërshtarët;²⁰⁷⁸ (ii) personalisht morën pjesë në disa nga krimet e përfshira në Pikat 1-10;²⁰⁷⁹ dhe (iii) vizituan shumë prej vendndodhjeve të përmendura në Pikat 1-10 si dhe ofruan forma të ndryshme të ndihmës praktike dhe mbështetjes morale.²⁰⁸⁰ Duke qenë se të katër të dyshuarit ishin drejtues të lartë të UÇK-së dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me autoritet të njohur gjerësisht,²⁰⁸¹ kontributi i tyre i lartpërmendur ndikoi në masë të konsiderueshme në kryerjen e krimeve.

481. Në lidhje me elementin subjektiv të kësaj forme përgjegjësie penale, materiali mbështetës tregon se të dyshuarit ishin në dijeni të elementeve thelbësore të krimeve të kryera dhe dinin se sjellja e tyre ndihmoi në kryerjen e tyre. Konkretisht, këto njohuri të dyshuarit i siguruan nga: (i) pjesëmarrja personale e tyre në kryerjen e disa prej krimeve, si dhe vizitat e tyre të vendndodhjeve të përmendura në Pikat 1-10;²⁰⁸² (ii) mbështetja e tyre politike, logjistike, financiare dhe ushtarake për anëtarët e NKP-së;²⁰⁸³ (iii) raportet që i dërgoheshin Shtabit të

²⁰⁷⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 52, 173.

²⁰⁷⁸ *Shih më lart*, para. 456, 461, 465, 469 dhe poshtëshënimet 1953, 1954, 1955, 1956, 1957 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁷⁹ *Shih më lart*, para. 457, 462, 466, 470 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁸⁰ *Shih më lart*, para. 459, 463, 467, 472 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁸¹ *Shih më lart*, para. 455, 460, 464, 468 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁸² *Shih më lart*, para. 457, 462, 466, 470 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²⁰⁸³ SITF00243018-00243022-ET e rishikuar, f. 3; [REDAKTUAR].

Përgjithshëm të UÇK-së dhe kontaktet e rregullta me komandantët e zonave;²⁰⁸⁴
(iv) takimet me përfaqësuesit ndërkombëtarë;²⁰⁸⁵ dhe (v) informacioni i disponueshëm publikisht.²⁰⁸⁶

482. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, gjithashtu dhe si alternativë ndaj përgjegjësisë penale të pretenduar të të dyshuarve për kryerje krimesh, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi ndihmuan dhe inkurajuan krimet e përfshira në Pikat 1-10, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

4. Përgjegjësia eprore

483. Gjithashtu dhe si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë penale në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit, në Aktakuzën e Rishikuar ZPS-ja pretendon se të dyshuarit mbajnë përgjegjësi penale si eprorë sipas nenit 16(1)(c) të Ligjit, për të gjitha krimet e përfshira në Pikat 1-10.²⁰⁸⁷

(a) Z. Thaçi

484. Sa i përket marrëdhënies epror-vartës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se materiali mbështetës tregon që z. Thaçi ishte një nga anëtarët themelues të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së²⁰⁸⁸ dhe e pati këtë rol gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës.²⁰⁸⁹ Shtabi i Përgjithshëm ishte organ që përfshinte një numër mjaft të kufizuar anëtarësh dhe funksiononte mbi bazën e ndarjes së detyrave dhe

²⁰⁸⁴ [REDAKTUAR].

²⁰⁸⁵ [REDAKTUAR].

²⁰⁸⁶ [REDAKTUAR].

²⁰⁸⁷ Aktakuza e Rishikuar, para. 53-55, 173, 174 [68].

²⁰⁸⁸ [REDAKTUAR].

²⁰⁸⁹ [REDAKTUAR].

përgjegjësi midis anëtarëve të vet.²⁰⁹⁰ Afërsisht, nga qershori i 1998, z. Thaçi u bë gjithashtu shef i departamentit të informimit të UÇK-së²⁰⁹¹ dhe shef i departamentit politik të UÇK-së.²⁰⁹² Në bazë të Rregullores së Disiplinës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Rregullorja Disiplinore e UÇK-së), shefat e departamenteve në thelb kishin të njëjtat kompetenca si komandantët e rangut më të lartë.²⁰⁹³ Me krijimin e QPK-së nga fundi i marsit 1999, z. Thaçi u bë Kryeministër pas miratimit prej komandantëve të zonave.²⁰⁹⁴ Si Kryeministër, z. Thaçi gjithashtu ishte edhe Kryekomandanti i UÇK-së²⁰⁹⁵ dhe në këtë cilësi nënshkroi Zotimin e UÇK-së më 21 qershor 1999.²⁰⁹⁶

485. Materiali mbështetës tregon sesi shef i dy drejtorive, në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së z. Thaçi kishte zyrtarisht kompetencë, ndër të tjera, për lavdërim, ngritje në pozitë, qortime, vërejtje, masa disiplinore (duke përfshirë ndalimin disiplinor deri në 25 ditë) dhe shfuqizimin e tyre, ose shkarkimin nga detyra të luftëtarëve të UÇK-së.²⁰⁹⁷ Ndër shembuj të tjerë të kompetencave që ushtronte z. Thaçi në rolet e tij ndryshme gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshihen: (i) udhëheqja e procesit të hyrjes së rekrutëve të UÇK-së në Kosovë në pranverë të vitit 1998;²⁰⁹⁸ (ii) pritja dhe dislokimi i rekrutëve në pozicione të caktuara;²⁰⁹⁹ (iii) lëshimi i udhëzimeve për komandantët, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, lidhur me çështje operative (si për shembull bashkërendimi i vijave për furnizim me armë dhe municione),²¹⁰⁰ ose çështje të

²⁰⁹⁰ [REDAKTUAR].

²⁰⁹¹ [REDAKTUAR].

²⁰⁹² [REDAKTUAR].

²⁰⁹³ [REDAKTUAR].

²⁰⁹⁴ [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

²⁰⁹⁵ [REDAKTUAR].

²⁰⁹⁶ [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu më lart*, para. 134 (Kriteret kontekstuale të krimeve të luftës).

²⁰⁹⁷ [REDAKTUAR].

²⁰⁹⁸ [REDAKTUAR].

²⁰⁹⁹ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁰ [REDAKTUAR].

tjera civile dhe administrative;²¹⁰¹ (iv) ndërhyrja e tij, së bashku me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis komandantëve lidhur me ndarjen e zonave të përgjegjësive;²¹⁰² dhe (v) pjesëmarrja e tij në emërimin e komandantëve.²¹⁰³ Materiali mbështetës gjithashtu tregon se pushteti udhëheqës i z. Thaçi brenda UÇK-së ishte i dukshëm dhe se anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm i jepnin përparësi zotit Thaçi për marrjen e vendimeve.²¹⁰⁴

486. Sipas materialit mbështetës, si Kryeministër, z. Thaçi kishte kompetencë, ndër të tjera, të emëronte personat kyç të qeverisë,²¹⁰⁵ si për shembull ministrin e Mbrojtjes (që i raportonte drejtpërsëdrejti Kryeministrit),²¹⁰⁶ kryeshefin e Shtabit të UÇK-së,²¹⁰⁷ komandantin e Gardës Kombëtare,²¹⁰⁸ dhe shefin e Shërbimit të Zbulimit (që i raportonte drejtpërsëdrejti Kryeministrit).²¹⁰⁹

487. Kjo tregon që z. Thaçi kishte aftësinë materiale të parandalonte kryerjen e krimeve dhe t'i ndëshkonte vartësit e tij në kohën e kryerjes së krimeve. Bazuar në sa më lart, rrjedh që gjatë periudhës përkatëse që lidhet me akuzat, ekzistonte marrëdhënie epror-vartës ndërmjet z. Thaçi dhe anëtarëve të UÇK-së në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar.

²¹⁰¹ [REDAKTUAR].

²¹⁰² [REDAKTUAR].

²¹⁰³ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁴ [REDAKTUAR]; IT-05-87 6D00067, f. 23 (U003-9108) ("Ne po bënim luftën. Prania e Hashimit ishte e rëndësishme për moralin").

²¹⁰⁵ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁶ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁷ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁸ [REDAKTUAR].

²¹⁰⁹ [REDAKTUAR].

488. Sa u përket krimeve të kryera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij lidhur me krimet e paraqitura në Pikat 1-10, të kryera nga vartësit e z. Thaçi.²¹¹⁰

489. Sa i përket njohurisë së z. Thaçi, materiali mbështetës tregon se ai ishte i pranishëm në një numër vendndodhjesh ku u kryen krimet e paraqitura në aktakuzë, përfshirë në kohët e pretenduara në Aktakuzën e Rishikuar.²¹¹¹ Ai gjithashtu ishte dëshmitar i keqtrajttimeve të viktimave nga anëtarë të UÇK-së në ato vendndodhje.²¹¹² Z. Thaçi informohej edhe nga burime të tjera. Për shembull, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe si kryekomandant, z. Thaçi takohej me komandantët e zonave operative në terren.²¹¹³ Raportet i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë z. Thaçi, dhe komunikoheshin rregullisht me komandantët e zonave.²¹¹⁴ Bazuar në materialin mbështetës, gjatë periudhës së Aktakuzës z. Thaçi pati disa mbledhje me përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, në të cilat u informua shprehimisht për krimet e kryera apo që kryheshin nga anëtarë të UÇK-së.²¹¹⁵ Për më tepër, z. Thaçi dhe anëtarë të tjerë të lartë të UÇK-së, në veçanti anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, kishin në dispozicion mjete të komunikimit, si për shembull korrierë, radiolidhje dhe telefona satelitorë, çka i mundësonte z. Thaçi kontakt të përditshëm me anëtarët e UÇK-së në zonat operative.²¹¹⁶ E gjithë kjo ndodhi në një kontekst kur dihej gjerësisht për keqtrajtimet e civilëve të kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë

²¹¹⁰ *Shih më lart*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 351-360 (Pikat 6-7), para. 362-417 (Pikat 8-9), para. 419-436 (Pikat 10) dhe para. 438-444 (Pika 1).

²¹¹¹ Likoc: [REDAKTUAR]; zona e gjerë operative e Drenicës: IT-05-87 6D00067, f. 14, 21, 23 (U003-9097, U003-9104, U003-9106); Jabllanicë: [REDAKTUAR]; Drenoc: [REDAKTUAR]; Malishevë: [REDAKTUAR]; Kleçkë: [REDAKTUAR]; Bare dhe Bajgorë: [REDAKTUAR]; zonat operative të Shalës dhe Llapit: [REDAKTUAR]; Kukës: [REDAKTUAR]; Rahovec: [REDAKTUAR].

²¹¹² *Shih më lart*, para. 271 (Pikat 4-5), para. 457 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët).

²¹¹³ [REDAKTUAR].

²¹¹⁴ [REDAKTUAR].

²¹¹⁵ [REDAKTUAR].

²¹¹⁶ [REDAKTUAR].

periudhës së aktakuzës, përfshirë për rrëmbimet, ndalimet, rrahjet dhe vrasjet.²¹¹⁷

Nga kjo rrjedh se z. Thaçi dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së krimeve të paraqitura në aktakuzë, ose i kishin kryer ato.

490. Në lidhje me mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej z. Thaçi, materiali mbështetës tregon se në cilësinë e tij si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, shëf i departamentit të Informimit, shëf i departamentit politik, Kryeministër dhe Kryekomandant i UÇK-së, z. Thaçi kishte detyrën e parandalimit të kryerjes së krimeve në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar, si dhe detyrën e ndëshkimit të vartësve të tij për krimet e kryera prej tyre gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Megjithatë, në materialin mbështetës nuk ka asgjë që të tregojë se z. Thaçi mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme në përmbushje të detyrave të tij si epror. Përkundrazi, në disa raste z. Thaçi miratoi veprimet e vartësve të tij përmes pranisë së tij në vendin e ngjarjes dhe mosmarrjes së masave kur ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave prej anëtarëve të UÇK-së.²¹¹⁸

491. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi mban përgjegjësi penale si epror, brenda kuptimit të nenit 16(1)(c) të Ligjit, për krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të përfshira në Pikat 1-10, sikurse konfirmohet në këtë vendim.

(b) Z. Veseli

492. Sa i përket marrëdhënies epror-vartës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se materiali mbështetës tregon që z. Veseli ishte një nga anëtarët themelues të

²¹¹⁷ [REDAKTUAR].

²¹¹⁸ *Shih më lart* para. 271 (Pikat 4-5), para. 457 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët); [REDAKTUAR].

Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së²¹¹⁹ dhe anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së [REDAKTUAR].²¹²⁰ Midis së paku qershorit 1998 dhe marsit 1999, ai ishte drejtor i G2-shit [REDAKTUAR], kurse në fund të marsit 1999, me krijimin e QPK-së, ai u bë shef i SHIK-ut.²¹²¹ Në këtë post z. Veseli u emërua nga z. Thaçi,²¹²² të cilit edhe i raportonte.²¹²³ Në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së, shefat e departamenteve/drejtorive kishin në thelb të njëjtat kompetenca si komandantët e rangut më të lartë.²¹²⁴

493. Sipas materialit mbështetës, si shef i një drejtorie, në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së z. Veseli zyrtarisht kishte kompetencë, ndër të tjera, për lavdërime, ngritje në pozitë, qortime, vërejtje, masa disiplinore (duke përfshirë ndalimin disiplinor deri në 25 ditë) dhe shfuqizimin e tyre, ose shkarkimin nga detyra të luftëtarëve të UÇK-së.²¹²⁵ Ndër shembuj të tjerë të kompetencave që ushtronte z. Veseli në rolet e tij ndryshme gjatë periudhës së aktakuzës, përfshihen: (i) udhëheqja e procesit të hyrjes së rekrutëve të UÇK-së në Kosovë në pranverë të vitit 1998;²¹²⁶ (ii) pritja dhe dislokimi i rekrutëve në pozicione të caktuara;²¹²⁷ (iii) kryerja e hetimeve;²¹²⁸ (iv) ndërhyrja e tij, së bashku me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis komandantëve lidhur me ndarjen e zonave të përgjegjësisë;²¹²⁹ (v) transferimi²¹³⁰ dhe lirimi²¹³¹ i një të ndaluar; dhe (vi) trajtimi i një kërkesë për masë disiplinore

²¹¹⁹ [REDAKTUAR].

²¹²⁰ [REDAKTUAR].

²¹²¹ [REDAKTUAR].

²¹²² [REDAKTUAR].

²¹²³ [REDAKTUAR].

²¹²⁴ [REDAKTUAR].

²¹²⁵ [REDAKTUAR].

²¹²⁶ [REDAKTUAR].

²¹²⁷ [REDAKTUAR].

²¹²⁸ [REDAKTUAR].

²¹²⁹ [REDAKTUAR].

²¹³⁰ [REDAKTUAR].

²¹³¹ [REDAKTUAR].

kundër Ramush Haradinajt për mënyrën e trajtimit të ushtarëve të vet.²¹³²
Materiali mbështetës gjithashtu tregon sesi anëtar i udhëheqjes kryesore, z. Veseli kishte pushtet dhe emër brenda UÇK-së.²¹³³

494. Kjo tregon se z. Veseli kishte aftësinë materiale të parandalonte kryerjen e krimeve dhe t'i ndëshkonte vartësit e tij në kohën e kryerjes së krimeve. Bazuar në sa më lart, rrjedh që gjatë periudhës përkatëse që lidhet me akuzat, ekzistonte marrëdhënie epror-vartës ndërmjet z. Veseli dhe anëtarëve të UÇK-së në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar.

495. Sa u përket krimeve të kryera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij lidhur me krimet e paraqitura në Pikat 1-10, të kryera nga vartësit e z. Veseli.²¹³⁴

496. Sa i përket njohurisë së z. Veseli, materiali mbështetës tregon se ai ishte i pranishëm në një numër vendndodhjesh ku u kryen krimet e paraqitura në aktakuzë, përfshirë në kohët e pretenduara në Aktakuzën e Rishikuar.²¹³⁵ Ai gjithashtu ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave nga anëtarë të UÇK-së në ato vendndodhje.²¹³⁶ Z. Veseli informohej edhe nga burime të tjera. Për shembull, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, z. Veseli takohej me komandantët e zonave operative në terren.²¹³⁷ Raportet i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë z. Veseli, dhe komunikohej rregullisht me komandantët e zonave.²¹³⁸ Në veçanti, si shef i departamentit të shërbimit të zbulimit, z. Veseli, së

²¹³² [REDAKTUAR].

²¹³³ [REDAKTUAR].

²¹³⁴ *Shih më lart*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 351-360 (Pikat 6-7), para. 362-417 (Pikat 8-9), para. 419-436 (Pikat 10) dhe para. 438-444 (Pika 1).

²¹³⁵ Likoc: [REDAKTUAR]; zona e gjerë operative e Drenicës: IT-05-87 6D00067, f. 14 (U003-9097); Jabllanicë: [REDAKTUAR]; Drenoc: [REDAKTUAR]; Malishevë: [REDAKTUAR]; Kleçkë: [REDAKTUAR]; Kukës: [REDAKTUAR]; Rahovec: [REDAKTUAR].

²¹³⁶ *Shih më lart*, para. 175 (Pikat 2-3), para. 291 (Pikat 4-5) dhe para. 462 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²¹³⁷ [REDAKTUAR].

²¹³⁸ [REDAKTUAR].

bashku me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, kishte qasje në informacion në lidhje me identifikimin e kundërshtarëve që vinte drejtpërsëdrejti nga personeli i zonave operative.²¹³⁹ Gjithashtu, në korrik 1998, z. Veseli, së bashku me z. Thaçi, mori pjesë në një mbledhje me përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, në të cilën u informua shprehimisht për krimet e kryera apo që kryheshin nga anëtarë të UÇK-së.²¹⁴⁰ Në përgjithësi, si anëtar me pozitë të lartë i UÇK-së, z. Veseli kishte në dispozicion mjete komunikimi, si për shembull korrierë, radiolidhje dhe telefona satelitorë, çka i mundësonte kontakt të përditshëm me anëtarët e UÇK-së në zonat operative.²¹⁴¹ E gjithë kjo ndodhi në një kontekst kur dihej gjerësisht për keqtrajtimet e civilëve të kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës së aktakuzës, përfshirë për rrëmbimet, ndalimet, rrahjet dhe vrasjet.²¹⁴² Nga kjo rrjedh se z. Veseli dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së krimeve të paraqitura në aktakuzë, ose i kishin kryer ato.

497. Në lidhje me mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej z. Veseli, materiali mbështetës tregon se në cilësinë e tij si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së dhe shef i departamentit të shërbimit të zbulimit, z. Veseli kishte detyrën e parandalimit të kryerjes së krimeve në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar, si dhe detyrën e ndëshkimit të vartësve të tij për krimet e kryera prej tyre gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Megjithatë, në materialin mbështetës nuk ka asgjë që të tregojë se z. Veseli mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme në përmbushje të detyrave të tij si epror. Përkundrazi, në disa raste, z. Veseli miratoi veprimet e

²¹³⁹ [REDAKTUAR].

²¹⁴⁰ [REDAKTUAR].

²¹⁴¹ [REDAKTUAR].

²¹⁴² [REDAKTUAR].

varësve të tij me praninë e tij në vendin e ngjarjes dhe mosmarrjen e masave kur ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave prej anëtarëve të UÇK-së.²¹⁴³

498. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Veseli mban përgjegjësi penale si epror, brenda kuptimit të nenit 16(1)(c) të Ligjit, për krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të përfshira në Pikat 1-10, sikurse konfirmohet në këtë vendim.

(c) Z. Selimi

499. Sa i përket marrëdhënies epror-varës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se materiali mbështetës tregon që z. Selimi ishte një nga anëtarët themelues të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe pati këtë rol gjatë gjithë vitit 1998 si dhe në vitin 1999.²¹⁴⁴ Afërsisht në mars 1998, z. Selimi u bë shef i G3-shit,²¹⁴⁵ kurse nga korriku 1998 ishte inspektor i përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.²¹⁴⁶ Në fillim të prillit 1999, z. Thaçi emëroi z. Selimi ministër të Rendit Publik të QPK-së.²¹⁴⁷ Në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së, shefat e departamenteve/drejtorive në thelb kishin të njëjtat kompetenca si komandantët e rangut më të lartë.²¹⁴⁸ Gjithashtu, si inspektor i përgjithshëm, z. Selimi kishte për detyrë të vlerësonte gatishmërinë e njëjësive të UÇK-së në aspektin operativ, si dhe të vlerësonte nëse mungonte disiplina, në ç'rast i informonte komandantët

²¹⁴³ *Shih më lart*, para. 175 (Pikat 2-3), para. 291 (Pikat 4-5) dhe para. 462 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I). [REDAKTUAR].

²¹⁴⁴ [REDAKTUAR].

²¹⁴⁵ [REDAKTUAR].

²¹⁴⁶ [REDAKTUAR].

²¹⁴⁷ [REDAKTUAR].

²¹⁴⁸ [REDAKTUAR].

përgjegjës.²¹⁴⁹ Përgjithësisht, z. Selimi konsiderohej gjithmonë person me pushtet brenda UÇK-së²¹⁵⁰ i cili vizitoi më së shpeshti komandantët në terren,²¹⁵¹ si dhe një nga anëtarët e paktë të Shtabit të Përgjithshëm që mbeti në Kosovë deri në fund të konfliktit të armatosur, ndërkohë që shumica e tyre ishin në Shqipëri.²¹⁵²

500. Sipas materialit mbështetës, si shef i një drejtorie, në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së z. Selimi zyrtarisht kishte kompetencë, ndër të tjera, për lavdërime, ngritje në pozitë, qortime, vërejtje, masa disiplinore (duke përfshirë ndalimin disiplinor deri në 25 ditë) dhe shfuqizimin e tyre, ose shkarkimin nga detyra të luftëtarëve të UÇK-së.²¹⁵³ Ndër shembuj të tjerë të kompetencave që ushtronte z. Selimi në rolet e tij të ndryshme gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshihen: (i) dislokimi i rekrutëve të UÇK-së;²¹⁵⁴ (ii) pjesëmarrja në emërimin e komandantëve të zonave;²¹⁵⁵ (iii) përfshirja në hetimin e rasteve disiplinore;²¹⁵⁶ (iv) gjetja e arsyeve për arrestimin dhe çarmatimin e personave;²¹⁵⁷ dhe (v) marrja e vendimeve për lirimin e të ndaluarve.²¹⁵⁸

501. Kjo tregon që z. Selimi kishte aftësinë materiale të parandalonte kryerjen e krimeve dhe t'i ndëshkonte vartësit e tij në kohën e kryerjes së krimeve. Bazuar në sa më lart, rrjedh që gjatë periudhës përkatëse që lidhet me akuzat, ekzistonte marrëdhënie epror-vartës ndërmjet z. Selimi dhe anëtarëve të UÇK-së në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar.

²¹⁴⁹ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁰ [REDAKTUAR].

²¹⁵¹ [REDAKTUAR].

²¹⁵² [REDAKTUAR].

²¹⁵³ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁴ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁵ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁶ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁷ [REDAKTUAR].

²¹⁵⁸ [REDAKTUAR].

502. Sa u përket krimeve të kryera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij lidhur me krimet e përfshira në Pikat 1-10, të kryera nga vartësit e z. Selimi.²¹⁵⁹

503. Në lidhje me njohurinë së z. Selimi, materiali mbështetës tregon se ai ishte i pranishëm në një numër vendndodhjesh ku u kryen krimet e paraqitura në aktakuzë, duke përfshirë në kohët e pretenduara në Aktakuzën e Rishikuar.²¹⁶⁰ Në fakt, z. Selimi [REDAKTUAR] ishte i pranishëm në terren, ndër të tjera në zonat e Dukagjinit, Drenicës, Pashtrikut, Nerodimes, Shalës dhe Llapit.²¹⁶¹ Z. Selimi pranoi vetë që e dinte se persona që nuk ishin luftëtarë, ishin ndaluar prej anëtarëve të UÇK-së së paku para 28 nëntorit 1998, por nuk e dinte vendin e saktë të ndalimit.²¹⁶² Ai gjithashtu ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave nga anëtarë të UÇK-së, ose miratoi keqtrajtime të tilla përmes pjesëmarrjes së tij në marrjen në pyetje të viktimave.²¹⁶³ Z. Selimi informohej edhe nga burime të tjera. Për shembull, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, z. Selimi takohej me komandantët e zonave operative në terren.²¹⁶⁴ Raportet i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, përfshirë z. Selimi, dhe komunikoheshin rregullisht me komandantët e zonave.²¹⁶⁵ Përgjithësisht, si anëtar me pozitë të lartë i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, ai kishte në dispozicion mjete të komunikimit, si për shembull korrierë, radiolidhje dhe telefona satelitorë, çka i mundësonte të komunikonte me anëtarët e UÇK-së në zonat operative.²¹⁶⁶ Të gjitha këto ndodhën

²¹⁵⁹ *Shih më lart*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 351-360 (Pikat 6-7), para. 362-417 (Pikat 8-9), para. 419-436 (Pikat 10) dhe para. 438-444 (Pika 1).

²¹⁶⁰ Likoc: [REDAKTUAR]; zona e gjerë operative e Drenicës: IT-05-87 6D00067, f. 14 (U003-9097); Jabllanicë: [REDAKTUAR]; Drenoc: [REDAKTUAR]; Kleçkë: [REDAKTUAR]; Bare dhe Bajgorë: [REDAKTUAR]; zonat operative të Shalës dhe Llapit: [REDAKTUAR]; Rahovec: [REDAKTUAR].

²¹⁶¹ [REDAKTUAR].

²¹⁶² [REDAKTUAR].

²¹⁶³ *Shih më lart*, para. 271, 279 (Pikat 4-5), para. 359 (Pikat 6-7), para. 466 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²¹⁶⁴ [REDAKTUAR].

²¹⁶⁵ [REDAKTUAR].

²¹⁶⁶ [REDAKTUAR].

në një kontekst kur dihej gjerësisht për keqtrajtimet e civilëve të kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshirë për rrëmbimet, ndalimet, rrahjet dhe vrasjet.²¹⁶⁷ Nga kjo rrjedh se z. Selimi dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së krimeve të paraqitura në aktakuzë, ose i kishin kryer ato.

504. Në lidhje me mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej z. Selimi, materiali mbështetës tregon se në cilësinë e tij si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, shef i drejtorisë operative, inspektor i përgjithshëm dhe ministër i Rendit Publik, z. Selimi kishte detyrën e parandalimit të kryerjes së krimeve në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar, si dhe detyrën e ndëshkimit të vartësve të tij për krimet e kryera prej tyre gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Megjithatë, në materialin mbështetës nuk ka asgjë që të tregojë se z. Selimi mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme në përmbushje të detyrave të tij si epror. Përkundrazi, në disa raste, z. Selimi miratoi veprimet e vartësve të tij me praninë e tij në vendin e ngjarjes, pjesëmarrjen në marrjen në pyetje dhe mosmarrjen e masave kur ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave prej anëtarëve të UÇK-së.²¹⁶⁸

505. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale si epror, brenda kuptimit të nenit 16(1)(c) të Ligjit, për krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të përfshira në Pikat 1-10, sikurse konfirmohet në këtë vendim.

²¹⁶⁷ [REDAKTUAR].

²¹⁶⁸ *Shih më lart*, para. 271, 279 (Pikat 4-5), para. 359 (Pikat 6-7), para. 466 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I). [REDAKTUAR].

(d) Z. Krasniqi

506. Sa i përket marrëdhënies epror-vartës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se materiali mbështetës tregon që z. Krasniqi ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që nga fundi i vitit 1996 ose fillimi i vitit 1997.²¹⁶⁹ Në vitin 1998, ai ishte anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së,²¹⁷⁰ shef i departamentit për qeverisjen lokale²¹⁷¹ dhe u emërua zëdhënës zyrtar i UÇK-së në qershor të atij viti.²¹⁷² Në nëntor 1998, z. Krasniqi gjithashtu u emërua zyrtarisht zëvendëskomandant për mbështetje dhe vazhdoi të ishte një nga përfaqësuesit politikë të UÇK-së dhe zëdhënës i saj.²¹⁷³ Në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së, shefat e departamenteve/drejtorive në thelb kishin të njëjtat kompetenca si komandantët e rangut më të lartë.²¹⁷⁴

507. Materiali mbështetës tregon se, si shef i një drejtorie dhe më pas zëvendëskomandant, në bazë të Rregullores Disiplinore të UÇK-së, z. Krasniqi zyrtarisht kishte kompetencë, ndër të tjera, për lavdërime, ngritje në pozitë, qortime, vërejtje, masa disiplinore (duke përfshirë ndalimin disiplinor deri në 25 ditë) dhe shfuqizimin e tyre, ose shkarkimin nga detyra të luftëtarëve të UÇK-së.²¹⁷⁵ Materiali mbështetës gjithashtu sugjeron se gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, z. Krasniqi ishte ai që kishte për detyrë të shpërndante të gjitha urdhrat, udhëzimet dhe informacionet në emër të Shtabit të Përgjithshëm,²¹⁷⁶ rrjedhimisht, komandantët e zonave komunikonin me Shtabin e Përgjithshëm përmes z. Krasniqi dhe bashkërendonin punën e tyre nëpërmjet tij meqenëse ai ishte i vetmi anëtar i Shtabit të Përgjithshëm që njerëzit e njohnin publikisht.²¹⁷⁷ Karakteri publik

²¹⁶⁹ IT-04-84 P00340, f. 21 (3305).

²¹⁷⁰ [REDAKTUAR].

²¹⁷¹ [REDAKTUAR].

²¹⁷² [REDAKTUAR].

²¹⁷³ [REDAKTUAR].

²¹⁷⁴ [REDAKTUAR].

²¹⁷⁵ [REDAKTUAR].

²¹⁷⁶ [REDAKTUAR].

²¹⁷⁷ [REDAKTUAR].

i z. Krasniqi si i vetmi anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që njihej gjerësisht, e bëri atë të respektuar dhe njohur ndër anëtarët e UÇK-së²¹⁷⁸ dhe në komunitetin ndërkombëtar.²¹⁷⁹ Ndër shembuj të tjerë të kompetencave që ushtronte z. Krasniqi në rolet e tij të ndryshme gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshihen: (i) ndërhyrja e tij, së bashku me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis komandantëve lidhur me ndarjen e zonave të përgjegjësisë;²¹⁸⁰ (ii) lëshimi i urdhrimit për arrestimin e një anëtari të UÇK-së [REDAKTUAR];²¹⁸¹ (iii) lëshimi i një urdhri për lirim të burgosurve;²¹⁸² dhe (iv) pjesëmarrja e tij në emërimin e komandantëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë.²¹⁸³

508. Kjo tregon që z. Krasniqi kishte aftësinë materiale të parandalonte kryerjen e krimeve prej vartësve të tij dhe t'i ndëshkonte ata në kohën e kryerjes së krimeve. Bazuar në sa më lart, rrjedh se gjatë periudhës përkatëse që lidhet me akuzat, ekzistonte marrëdhënie epror-vartës ndërmjet z. Krasniqi dhe anëtarëve të UÇK-së në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar.

509. Sa u përket krimeve të kryera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij lidhur me krimet e përfshira në Pikat 1-10, të kryera nga vartësit e z. Krasniqi.²¹⁸⁴

510. Në lidhje me njohurinë e z. Krasniqi, materiali mbështetës tregon se ai ishte i pranishëm në një numër vendndodhjesh ku u kryen krimet e paraqitura në

²¹⁷⁸ [REDAKTUAR].

²¹⁷⁹ [REDAKTUAR].

²¹⁸⁰ [REDAKTUAR].

²¹⁸¹ [REDAKTUAR].

²¹⁸² [REDAKTUAR].

²¹⁸³ [REDAKTUAR].

²¹⁸⁴ *Shih më lart*, para. 139-231 (Pikat 2-3), para. 233-349 (Pikat 4-5), para. 351-360 (Pikat 6-7), para. 362-417 (Pikat 8-9), para. 419-436 (Pika 10) dhe para. 438-444 (Pika 1).

aktakuzë, duke përfshirë në kohët e pretenduara në Aktakuzën e Rishikuar.²¹⁸⁵ Z. Krasniqi informohej edhe nga burime të tjera. Për shembull, z. Krasniqi mori raporte nga komandantët e zonave për rezultatet e operacioneve ushtarake, duke përfshirë edhe zënien e robërve,²¹⁸⁶ ose për mënyrën sesi t'i trajtonin ata.²¹⁸⁷ Ai gjithashtu u informua personalisht për krimet që kryheshin, ndër të cilat rrëmbimet, vrasjet dhe zhdukjet.²¹⁸⁸ Gjithashtu, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe për shkak të rolit të tij specifik si zëdhënës i UÇK-së, z. Krasniqi takohej dhe mbante kontakte të ngushta me komandantët e zonave operative në terren.²¹⁸⁹ Raportet i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë z. Krasniqi, dhe komunikoheshin rregullisht me komandantët e zonave.²¹⁹⁰ Përgjithësisht, si anëtar i lartë i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, z. Krasniqi kishte në dispozicion mjete të komunikimit, si për shembull korrierë, radiolidhje dhe telefona satelitorë, çka i mundësonte kontakt të përditshëm me anëtarët e UÇK-së në zonat operative.²¹⁹¹ Të gjitha këto ndodhën në një kontekst kur dihej gjerësisht për keqtrajtimet e civilëve të kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshirë për rrëmbimet, ndalimet, rrahjet dhe vrasjet.²¹⁹² Nga kjo rrjedh se z. Krasniqi dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së krimeve të paraqitura në aktakuzë, ose i kishin kryer ato.

511. Në lidhje me mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej z. Krasniqi, materiali mbështetës tregon se në cilësinë e tij si anëtar i Shtabit të

²¹⁸⁵ Likoc: [REDAKTUAR]; Jabllanicë: IT-04-84bis P00064, f. 135-136 (5075-5076); [REDAKTUAR]; Kleçkë: [REDAKTUAR]; zonat operative të Shalës dhe Llapit: [REDAKTUAR]; Malishevë: [REDAKTUAR]; Kukës: [REDAKTUAR].

²¹⁸⁶ [REDAKTUAR].

²¹⁸⁷ [REDAKTUAR].

²¹⁸⁸ [REDAKTUAR].

²¹⁸⁹ [REDAKTUAR].

²¹⁹⁰ [REDAKTUAR].

²¹⁹¹ [REDAKTUAR].

²¹⁹² [REDAKTUAR].

Përgjithshëm të UÇK-së, anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së, shef i departamentit për qeverisjen lokale, zëdhënës zyrtar i UÇK-së dhe zëvendëskomandant, z. Krasniqi kishte detyrën e parandalimit të kryerjes së krimeve në vendndodhjet e përfshira në Aktakuzën e Rishikuar, si dhe detyrën e ndëshkimit të vartësve të tij për krimet e kryera prej tyre gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Megjithatë, në materialin mbështetës nuk ka asgjë që të tregojë se z. Krasniqi mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme në përmbushje të detyrave të tij si epror. Përkundrazi, në disa raste z. Krasniqi miratoi veprimet e vartësve të tij me vetë praninë e tij në vendin e ngjarjes dhe mosmarrjen e masave kur ishte dëshmitar i keqtrajtimit të viktimave nga anëtarë të UÇK-së.²¹⁹³ Z. Krasniqi gjithashtu mori pjesë në një varg mbledhjesh të komandantëve të zonave me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, në të cilat u lëshuan urdhra për ndalimin e bashkëpunësorëve dhe ngritjen e qendrave të ndalimit për atë qëllim.²¹⁹⁴

512. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Krasniqi mban përgjegjësi penale si epror, brenda kuptimit të nenit 16(1)(c) të Ligjit, për krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të përfshira në Pikat 1-10, sikurse konfirmohet në këtë vendim.

VII. KËRKESA SHOQËRUESE PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

513. Si rregull i përgjithshëm, rregulla 88(1) e Rregullores përcakton se pas konfirmimit, aktakuza bëhet publike. Po kështu, në pajtim me rregullat 95(1) dhe (2)(b) dhe 102(1)(a) të Rregullores, nxjerrja e materialeve, ndër të tjera nxjerrja e emrave të dëshmitarëve dhe viktimave, bëhet pas paraqitjes së parë të të akuzuarit

²¹⁹³ *Shih më lart*, para. 251 (Pikat 4-5), para. 470 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët). [REDAKTUAR].

²¹⁹⁴ [REDAKTUAR].

për të cilin është konfirmuar një aktakuzë. Megjithatë, në rrethana të veçanta dhe pasi të jenë paraqitur arsye të vlefshme, në përputhje me rregullat 88(2) dhe 105(1) të Rregullores, ZPS-ja mund të bëjë kërkesë që mosnxjerrja e përkohshme e aktakuzës, e dokumenteve në lidhje me të dhe e identitetit të viktimave dhe dëshmitarëve, të mbetet në fuqi edhe pas konfirmimit të aktakuzës ose, sipas rastit, paraqitjes së parë të të akuzuarit. Theksohet se masat e përcaktuara në rregullën 105(1) janë të përkohshme, për të mundësuar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të cenueshme deri sa të parashtrohet një kërkesë për masa mbrojtëse.

514. Në lidhje me rrezikun e arratisjes së të dyshuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh: (i) vënien në dijeni të të dyshuarve për akuzat e konfirmuara, të paraqitura në aktakuzën që do t'u dorëzohet, dhe për dënimet e mundshme; (ii) dijeninë e tyre për vendimet e fajësisë penale kundër ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së dhe anëtarëve të identifikuar me emër të NKP-së, të raportuara publikisht;²¹⁹⁵ (iii) postet e tyre të larta aktuale apo në të shkuarën, përkatësisht në UÇK dhe/ose qeverinë e Kosovës,²¹⁹⁶ çka u mundëson atyre të mobilizojnë një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh;²¹⁹⁷ (iv) mundësinë e tyre për të udhëtuar në juridiksione që nuk kanë detyrimin e transferimit të tyre në Dhomat Specializuara; dhe (v) fondet dhe burimet e tyre të konsiderueshme, çka demonstroi motivin dhe aftësinë e tyre për t'u arratisur.²¹⁹⁸

515. Në lidhje me ndërhyrjen ndaj viktimave, dëshmitarëve dhe bashkëkryesve të pretenduar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin që të dyshuarit mbajnë poste me pushtet dhe ndikim në Kosovë dhe rrjedhimisht kanë aftësinë për të mobilizuar përkrahës në orvatjet e tyre për të penguar hetimin dhe

²¹⁹⁵ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 19-24, 31.

²¹⁹⁶ *Shih më lart*, para. 455, 460, 464, 468 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I).

²¹⁹⁷ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 4-5, 32.

²¹⁹⁸ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 32.

procedimin penal të tyre.²¹⁹⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu mban parasysh përpjekjet e pretenduara të të dyshuarve për delegjitimimin e DHSK-së²²⁰⁰ dhe pengimin e proceseve gjyqësore të mëparshme²²⁰¹ dhe të tashme²²⁰².

516. Në lidhje me kryerjen e krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se sipas akuzave, të dyshuarit ishin pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët që kishte në shënjestër kundërshtarët e UÇK-së.²²⁰³ Duke marrë parasysh orvatjet e pretenduara për pengimin e procesit gjyqësor,²²⁰⁴ si dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit që ka dëmtuar procedimet kundër ish-anëtarëve të UÇK-së,²²⁰⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rrezik i konsiderueshëm i kryerjes së mundshme të krimeve të dhunës kundër individëve të cilët të dyshuarit i konsiderojnë se janë kundër tyre.

517. Duke mbajtur parasysh faktorët e përmendur në paragrafët 514-516 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-ja ka paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin rrethana të veçanta të cilat lejojnë, në përputhje me rregullën 88(2) të Rregullores, mosnxjerrjen e përkohshme për publikun të dokumenteve vijuese dhe, sipas rastit, të shtojcave të tyre: (i) aktakuzës, ashtu sikurse është konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”); dhe (ii) F00002, F00003, F00005, F00006, F00008, F00011, F00012, F00014, F00018, F00022, F00024 (“dokumente në lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar”).

518. Duke mbajtur parasysh faktorët e përmendur në paragrafët 515-516 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka demonstruar ekzistencën e rrethanave të veçanta sipas rregullës 105(1) të Rregullores që

²¹⁹⁹ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 4-5, 34.

²²⁰⁰ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 7; Shtojca 2 e parashtrimit për urdhra të tjerë, Pjesa 1A, Pjesa II.

²²⁰¹ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 8-9.

²²⁰² Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 10-17; Shtojca 3 e parashtrimit për urdhra të tjerë, f. 8.

²²⁰³ Aktakuza e Rishikuar, para. 32.

²²⁰⁴ *Shih më lart*, para. 515.

²²⁰⁵ Parashtrim për urdhra të tjerë, para. 18-26.

përligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave deri sa të urdhërohen masa të përshtatshme mbrojtëse.

519. Për këtë arsye, mosnxjerrja e Aktakuzës së Konfirmuar për publikun²²⁰⁶ mbetet në fuqi deri në një urdhër tjetër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, por jo më gjatë se paraqitja e parë e të akuzuarve, në përputhje me rregullën 88(2) të Rregullores. Të akuzuarve u dorëzohet Aktakuza e Konfirmuar rreptësisht konfidenciale dhe me redaktime, sipas rastit, në përputhje me rregullat 87(1) dhe 105(1) të Rregullores. Pavarësisht nga konfidencialiteti i Aktakuzës së Konfirmuar, në pajtim me rregullën 88(3) të Rregullores, ZPS-ja dhe, sipas rastit, Administratorja, mund t'ua bëjnë të njohur versionin e redaktuar ose pjesë të tij, autoriteteve të Kosovës, të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykojnë të nevojshme për hetimin ose ndjekjen penale.

520. Mosnxjerrja e materialit mbështetës dhe dokumenteve në lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar mbetet në fuqi deri në një urdhër të mëtejshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, sikurse përcaktohet në rregullën 88(2) të Rregullores. Sidoqoftë, në përputhje me rregullat 102(1)(a) dhe 105(1) të Rregullores, materiali mbështetës u vihet në dispozicion të akuzuarve, me redaktimet e nevojshme sipas rastit, jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e parë e tyre.

VIII. VENDIM

521. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **KONFIRMON** akuzat e mëposhtme kundër z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi:

²²⁰⁶ Në kontekstin e këtij vendimi, termi "publik" nënkupton të gjithë personat, organizatat, subjektet, shtetet e treta, klientët, shoqatat dhe grupet, përfshirë edhe mediat, me përjashtim të gjykatësve të Dhomave të Specializuara (dhe personelit të tyre), Zyrës Administrative, ZPS-së, dhe të akuzuarve.

- i. përndjekje (Pika 1), burgosje (Pika 2), akte të tjera çnjerëzore (Pika 4), torturë (Pika 6), vrasje e paligjshme (Pika 8) dhe zhdukje me forcë e personave (Pika 10), si krime kundër njerëzimit, të ndëshkueshme në bazë të neneve 13 dhe 16(1)(a) të Ligjit; dhe
 - ii. ndalim arbitrar (Pika 3), trajtim mizor (Pika 5), torturë (Pika 7) dhe vrasje e paligjshme (Pika 9), si krime lufte, të ndëshkueshme në bazë të neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit;
- b. **URDHËRON** Prokurorin e Specializuar që brenda një jave nga njoftimi i këtij vendimi të dorëzojë një aktakuzë të rishikuar për herë të dytë, duke mbajtur parasysh konstatimet në paragrafin 226, e cila do të konsiderohet si “Aktakuza e Konfirmuar”;
- c. **AUTORIZON** ZPS-në që të redaktojë emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave apo dëshmitarëve të përmendur në Aktakuzën e Konfirmuar, në dokumentet në lidhje me të dhe materialin mbështetës, si dhe të caktojë dhe përdorë pseudonime të përkohshme për këto viktima dhe dëshmitarë;
- d. **URDHËRON** ZPS-në që të dorëzojë një version të redaktuar, rreptësisht konfidencial, të Aktakuzës së Konfirmuar brenda një jave nga njoftimi i këtij vendimi;
- e. **URDHËRON** Zyrën Administrative që, në këshillim me ZPS-në, t’u dorëzojë të akuzuarve versionin e redaktuar rreptësisht konfidencial, të Aktakuzës së Konfirmuar;
- f. **AUTORIZON** ZPS-në dhe Zyrën Administrative, sipas rastit, që versionin e redaktuar rreptësisht konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar apo pjesë të saj t’ua bëjë të njohur autoriteteve kosovare, të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se gjykohet e nevojshme për hetimin apo ndjekjen penale;
- g. **URDHËRON** mosnxjerrjen e dokumenteve në lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar dhe materialit mbështetës deri në një urdhër tjetër;

- h. **URDHËRON** mosbërjen publike të Aktakuzës së Konfirmuar deri në një urdhër tjetër; dhe
- i. **URDHËRON** ZPS-në që brenda një jave nga paraqitja e parë e të akuzuarve, të parashtrojë kërkesë për masa mbrojtëse, nëse janë të nevojshme, për viktimat dhe dëshmitarët e identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar, dokumentet në lidhje me të dhe materialin mbështetës.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 26 tetor 2020
Në Hagë, Holandë.